



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RAPORTI VJETOR

2016

Mars **2017**

PASQYRA E LËNDËS

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2.	QEVERISJA E AUTORITETIT	9
3.	DIGJITALIZIMI	11
3.1	Licencimi i rrjeteve numerike kombëtare	12
3.2	Digjitalizimi i rrjeteve numerike kombëtare	13
3.3	Digjitalizimi i rrjeteve analoge të operatorëve ekzistues	14
3.4	Kontrata AMA- RTSH	15
3.5	Procesi i migrimit të frekuencave	15
3.6	Lirimi i brezit të Dividendit Digjital	17
3.7	Fushata e informimit të publikut	18
4.	KËSHILLI I ANKESAVE	20
5.	AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM	23
5.1	Shqyrtimi analitik i përmbajtjeve të emetuara	23
5.3	Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave	29
5.4	Trajtimi i ankesave	32
6.	AUTORITETI NE PERMBUSHJE TE ZBATUESHMERISE LIGJORE	33
6.1	Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve	33
6.2	Përqasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive	36
6.3	Monitorimit i përmbajtjeve	39
6.4	Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave	40
6.5	Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje	41
7.	AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV	42
7.1	Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv	42
7.2	Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv	43
7.3	Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore	45

8. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL	48
8.1 Programi i transparencës	48
8.2 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore	49
8.3 Infrastruktura e Informacionit dhe njohurive	51
9. TREGUESIT FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE	52
9.1 Menaxhimi i burimeve financiare	52
9.2 Pasqyrat financiare	55

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në respektimin e parimeve themelore gjatë zhvillimit të veprimtarisë audiovizuale në drejtim të garantimit të lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe të së drejtës për informim si dhe duke besuar se shërbimet audiovizuale shqiptare duhet të reflektojnë vlerat dhe identitetin e shoqërisë shqiptare, zhvillimit në pavarësi të plotë dhe efikasitet cilësor editoriale si dhe duke përmbushur detyrimet ndërkombëtare për procesin e digjitalizimit, AMA në tërësinë e tij si institucion, ka përmbushur kryesisht rekomandimet e lëna të Kuvendit të Shqipërisë.

Në drejtim të angazhimit të Autoritetit në përmbylljen e të gjitha hallkave të parashikuara në procesin e digjitalizimit dhe finalizimin e këtij procesi, AMA ka ndërmarrë aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2016 ndër të cilët do të listonim:

- i. Licencimin e operatorëve privatë kombëtar numerikë. Në tregun audioviziv shqiptar tashmë janë 5 operatorë të licencuar nga AMA për ofrimin e transmetimeve numerike në nivel kombëtar duke konkluduar procesin e licencimit të shtatë rrjeteve numerike kombëtare, dy prej të cilëve i janë akorduar RTSH-së dhe nga një rrjet, subjekteve “Tv Klan” sh.a., “Digit-Alb” sh.a., “Top-Channel” sh.a., “Media Vizion” sh.a. dhe “ADTN” sh.a.
- ii. Koordinimin me operatorin publik shqiptar në lidhje me implementimin e dy rrjeteve numerike, si dhe zbatimin e detyrimeve ligjore dypalëshe duke luajtur rol nxitës në lidhje me sipërmarrjet e RTSH-së gjatë gjithë vitit 2016 ku fokusi ishte:
 - Përcaktimi kushteve dhe kriterëve ligjore, programore, teknike dhe financiare që duhet të përfshiheshin në kontratën e shërbimit që lidhet midis AMA-s dhe RTSH-së, duke u finalizuar me miratimin e saj nga AMA.
 - Përcaktimi kushteve dhe kriterëve të kontratës tip që lidhet midis RTSH-së dhe operatorëve lokalë/rajonalë.

Operatori publik shqiptar ka filluar transmetimet numerike në qarqet Tiranë dhe Durrës më datë 1 dhjetor 2016 dhe tashmë ka ndezur sinjalin numerik edhe në qarqet Lezhë, Fier, Berat dhe Dibër. RTSH ka ndërtuar infrastrukturën fizike edhe në qarqe të tjera të vendit, gjë që do të sjellë përshpejtimin e finalizimit të procesit të digjitalizimit.

- iii. Koordinimin me operatorët privatë kombëtarë të licencuar për transmetime numerike, lidhur me zbatimin e afateve të implementimit të rrjeteve të tyre numerike sipas përcaktimeve në licencat që ato zotërojnë, procesin e liritimit të frekuencave që përdornin në mënyrë të jashtëligjshme, procesin e migrimit të frekuencave si dhe përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për mbështetjen në rrjetet e tyre të operatorëve lokalë/rajonalë. Aktualisht janë depozituar kontratat nga 5 operatorë audiovizivë edhe pse nga RTSH informohemi se deri tani kanë lidhur marrëveshjen vetëm 10 nga 22 operatorë. Konsiderojmë që ka filluar procesi i mbartjes së operatorëve lokalë/rajonalë në rrjetet kombëtare në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë, Durrës) edhe pse kontratat e paraqitura janë të pakta në numër në krahasim me numrin e operatorëve që ofrojnë transmetime audiovizive në allotmentin e Tiranës. Ndërkohë, AMA është duke njoftuar

zyrtarisht operatorët privatë lokalë/rajonale të qarqeve Lezhë, Fier, Berat dhe Dibër të depozitojnë kontratat/marrëveshjet e lidhura me operatorët kombëtarë.

- iv. Koordinimin me operatorët analogë lokalë/rajonale lidhur me afatet kohore të përcaktuara në aktet ligjore të sipërpërmendura për mbështetjen e tyre në rrjetet kombëtare numerike, përfshirë edhe periudhën e simulcast-it (transmetimit njëkohësisht të transmetimeve analoge dhe numerike për një periudhë 1 muaj pas mbështetjes në rrjetet kombëtare); koordinim lidhur me zgjidhjet teknike të parashikuara nga këta operatorë mbi procesin e migrimit të frekuencave etj. Në këtë kuadër, AMA ka hartuar planin e migrimit të frekuencave në të cilin janë përcaktuar frekuencat që do t'i vihen në dispozicion operatorëve lokalë dhe rajonalë për të transmetuar për një periudhë kohore deri në mbështetjen e tyre në rrjetet kombëtare numerike si dhe frekuencat për operatorët kombëtarë për një periudhë kohore deri në ndërtimin e rrjeteve të tyre numerike.

AMA është përballur me vështirësi për përcaktimin e frekuencave në qarqet Tiranë, Durrës për shkak të numrit të madh të operatorëve që ka në këto qarqe, padisponueshmërisë së frekuencave për të kryer migrimin por sidomos nga zënia tyre në mënyrë të jashtëligjshme nga disa operatorë vendorë. Migrimi në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë, Durrës) është bërë i mundur vetëm pas lirimit të frekuencave që përdorshin në mënyrë të jashtëligjshme nga operatorët audiovizivë në këtë allotment.

Për më tepër, operatorët kombëtarë kanë shprehur në mënyrë të përsëritur në AMA, ankesa lidhur me zënien e frekuencave që u takojnë sipas licencës së lëshuar nga AMA që në prill 2016, pasi sillte pengesë në implementimin e rrjeteve të tyre kombëtare numerike. Në ankesat e paraqitura argumentohen dëmet financiare që rrjedhin nga vonesat në implementimin e rrjeteve numerike nisur nga fakti që operatorët kombëtarë paguajnë detyrime financiare për frekuencat që ende si kanë marrë në dorëzim, detyrime që rezultojnë në shumën totale prej 27,600,000 lekësh.

Nisur nga shqetësimet e theksuara më sipër, AMA ka njoftuar zyrtarisht në datat 09/11, 01/12 dhe 28/12 të vitit 2016 të gjithë operatorët ofrues të shërbimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë të cilët emetojnë nga pika transmetimi dhe frekuenca të paautorizuara, që të marrin masat e duhura për lirimin e frekuencave të zëna arbitrarisht dhe pa licencë brenda datës 31/12/2016. Gjatë procesit të lirimit të frekuencave, AMA ka hasur në rezistencën e disa operatorëve (Ora News, Tring TV) ndërkohë që i janë përgjigjur pozitivisht operatorët e tjerë "News 24", "Top Channel" dhe "Shijak TV".

Aktualisht është bërë i mundur lirimi i frekuencave të përcaktuara për ndërtimin e rrjeteve numerike kombëtare në qarqet Tiranë, Durrës, Shkodër dhe migrimi i operatorëve audiovizivë që kanë pasur në përdorim këto frekuenca në frekuenca të tjera jashtë planit numerik. Procesi i migrimit të frekuencave, do të vijojë të ndiqet nga AMA deri në përfundimin e plotë të procesit të digitalizimit, allotment pas allotmenti, bazuar në disponueshmërinë e frekuencave të lira.

- v. Organizimi i fushatës informuese për t'iu gjendur pranë publikut deri në përfundim të procesit të digjitalizimit. Fushatë e cila është organizuar në forma të ndryshme për të qenë sa më efektive dhe depërtues tek publiku shqiptar (spote televizive, broshura, fletëpalosje, struktura CallCenter, emisione televizive etj).

Përsa i përket funksionimit të plotë të AMA-s për mbarëvajtjen e proceseve si dhe miratimin e akteve të brendshme si kërkesë e ligjit, gjate 2016 u zgjodh anëtari i shtatë i AMA-s si dhe u rizgjodhën tre anëtarë te tjerë. Në këtë mënyrë u plotësuan vendet vakante të AMA-s duke shmangur situatat bllokuese me të cilat është përballur AMA, gjatë viteve të mëparshme. Gjatë vitit 2016, janë zhvilluar 15 mbledhje të Autoritetit të Mediave Audiovizive ku anëtarët kanë marrë pjesë kryesisht në çdo mbledhje.

Në përforsimin e qeverisjes dhe zhvillimit të tij si një autoritet, efikas dhe llogaridhënës, i angazhuar ndaj standardeve të larta të qeverisjes institucionale është miratuar rregullorja e Autoritetit si dhe rregullorja “Për Strukturën Organizative të Autoritetit të Mediave Audiovizive”, rregullore e cila synon realizimin në mënyrë të suksesshme dhe të plotë të detyrimeve funksionale që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit.

Gjithashtu është miratuar Kodi i Sjelljes i Anëtarëve të Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA), i cili është i lidhur ngushtë me rregullimin e veprimtarisë së anëtarëve të AMA-s si dhe administratës, apo bordeve që mund të ngrëjë.

Përgjatë vitit raportues në angazhim të përmbushjes së detyrimeve ligjore si dhe rritjes së besimit të publikut ndaj rregullatorit, Autoriteti draftoi strategjinë trevjeçare ku pasqyrohet mënyra e realizimit të funksioneve të veta ligjore. Dokumenti strategjik përmban misionin, vizionin, vlerat, qëllimet strategjike si dhe objektivat përkatëse të AMA-s, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe në parimet mbi të cilat funksionon Autoriteti.

Në vitin 2016 AMA ka startuar publikimin për herë të parë të Buletinit Periodik të AMA-s, një fluks të dhënash nga performanca e OSHMA-ve. Mbledhja, administrimi dhe publikimi i informacionit për sektorin e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, si një nga funksionet kryesore që i atribuohen AMA-s me ligj, ishte një nga shtysat kryesore për fillimin e botimit në mënyrë periodike të këtij Buletini për të prezantuar të gjitha grupeve të interesit tregues nga performanca e ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv, OSHMA-ve. Impakti i ndërtimit të një Buletini Periodik me tregues nga dinamika e tregut audio dhe audioviziv është i dyanshëm:

- së pari, AMA në çdo moment ka në dispozicion një depozitë të dhënash, që i referohen një periudhe kohore të caktuar, të aksesueshme në çdo moment nga vetë aktorët e tregut, subjektet dhe institucionet e interesuara, nga publiku i gjerë;
- së dyti, qarkullimi i Buletinit do të rrisë standardin e raportimit të treguesve të aktivitetit dhe performancës së OSHMA-ve, element që ndikon në cilësinë dhe vërtetësinë e një botimi të tillë, në print e online.

Gjithashtu në rritje të zbatueshmërisë ligjore duke konsideruar rolin e Autoritetit si në dizenjimin e politikave të duhura ashtu edhe për ekzekutimin e tyre, AMA përgjatë këtij viti ka vijuar punën për plotësimin e kuadrit nënligjor, nëpërmjet hartimit të akteve të reja rregullatorë por edhe draftimit të një sërë ndryshimeve në rregulloret ekzistuese.

Ndër të tjera rregullorja “Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit” parashikon rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së

transmetimit audio të komunitetit. Miratimi i këtij akti nënligjor i ka hapur rrugën procesit të dhënies së licencave për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit, dhe AMA me vendimin nr. 245, datë 21.12.2016 ka përcaktuar frekuencat për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit dhe ka çelur garën për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit. Në vijim, AMA në muajin dhjetor 2016, shpalli në mënyrë publike procedurën për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit për 4 zona ofrimi shërbimi.

Po ashtu, gjatë periudhës raportuese ka vijuar puna për rishikimin e legjislacionit sekondar, dhe për hartimin e akteve nënligjore të kërkuara prej ligjit organik.

Autoriteti në përmbushje të kompetencave të veta rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke garantuar konkurrencën e ndershme në fushën e mediave elektronike. Gjatë periudhës raportuese në AMA janë depozituar një sërë ankesash për mosrespektimin e të drejtave të transmetimit/autorit nga subjekte të licencuar/autorizuar ose jo, si dhe nga subjekte të tjerë të interesuar.

AMA ka ndjekur me prioritet të gjitha ankesat të depozituara pranë autoritetit, duke kryer inspektimet në terren apo monitorimet rast pas rasti. Në përfundim të procedurave administrative, AMA ka vendosur sipas rastit, tërheqjen e vëmendjes ndaj subjekteve ose dënimin e tyre me gjobë dhe, në rastet kur subjektet kanë rezultuar se kanë ushtruar aktivitet audioviziv pa autorizimin e AMA-s, ndaj tyre është bërë edhe sekuestrimi i pajisjeve transmetuese audiovizive.

Gjithsej gjatë vitit 2016 janë kryer 257 inspektime, nga të cilat janë marre masat e parashikuara, në përfundim të shqyrtimit të tyre, janë vendosur 58 vendime për dënim me gjobë, prej të cilave 32 janë shfuqizuar nga Këshilli i Ama-s.

Gjithashtu, për sa i përket subjekteve të pa licencuar/paautorizuar, gjatë vitit 2016, AMA ka ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme një numër të konsiderueshëm aksionesh për ndalimin e gjendjes së informalitetit në të cilin disa subjekte ushtronin aktivitet audioviziv.

Në këtë kuadër, AMA, në total për periudhën raportuese ka bërë ndalimin dhe sekuestrimin e pajisjeve audiovizive të 23 subjekteve audiovizive (kabllorë dhe iptv) të cilët ushtronin veprimtari audiovizive pa autorizim, apo licencë nga AMA. Asnjë prej këtyre vendimeve nuk është kundërshtuar në gjykatë. Pajisjet e sekuestruara janë trajtuar sipas akteve ligjore në fuqi, duke u dorëzuar pranë Arkivit të Shtetit.

Duke konsideruar statusin aktual të procesit të digjitalizimit, operatorët ekzistues privatë kombëtarë analogë janë duke investuar në ndërtimin e rrjeteve numerike duke mos kryer investime në rrjetet analoge përkatëse. Si rrjedhojë, perqindja e mbulimit me sinjal analog mbetet e pandryshuar me atë të vitetve të mëparshme të raportuara.

Ashtu si edhe gjatë vitit të kaluar, edhe përgjatë vitit 2016, një vëmendje e veçantë i është kushtuar garantimit të transparencës së vazhdueshme të veprimtarisë së AMA-s si dhe komunikimit dhe bashkëpunimit të pandërprerë me të gjithë subjektet e përfshirë në fushën e medias dhe të të drejtave të transmetimit/autorit. Theksohet se nga monitorimet e programeve të transmetuara është vënë re një zvogëlim i ndjeshëm i fenomenit të transmetimit të programeve pa pasur më parë të drejtat e autorit. Në mënyrë të veçantë, transmetimi i veprave

kinematografike nga transmetuesit lokalë, është kufizuar në transmetimin e veprave të prodhuara në Shqipëri dhe nga autorë shqiptarë, duke qenë se edhe sigurimi i të drejtave të transmetimit dhe atyre të autorit për këto vepra është dhe mbetet më e thjeshtë, në krahasim me të drejtat e veprave ndërkombëtare.

Mbetet shqetësim një dukuri e fund vitit dhe sjellja e disa subjekteve, privatë dhe juridike, të cilët operojnë në tregun shqiptar, duke pretenduar se zotërojnë të drejtat e autorit të veprave kinematografike, apo të drejtave të transmetimit për programe (kanale) televizivë. AMA ka filluar punën për identifikimin e saktë të këtyre të drejtave. Qëllimi kryesor është të ndihmojë operatorët audio dhe audiovizive të licencuar, apo autorizuar prej saj, që të identifikojnë më saktësi se cili subjekt ka, efektivisht, të drejtat e autorit dhe ato të transmetimit.

Gjate vitit raportues nga angazhimi i Autoritetit në përmirësimin e planit financiar, është shënuar përsëri rritje të të ardhurave të Autoritetit, si rrjedhojë e masave të marra për sigurimin e zbatueshmërisë së ligjit. Ndërkohe si pasojë e detyrimeve të mbartura ndër vite, për pagesat për licencë/autorizim dhe tarifat për shërbimet radiotelevizive, AMA gjatë vitit 2016, për 32 subjekte ka marrë vendimi për heqjen e licencës/autorizimit, nga këta subjekte, 2 shlyen tërësisht detyrimin ndaj AMA-s, ndërkohë 30 subjekte mbeten ende debitor.

Autoriteti gjatë 2016, ka bërë menaxhimin e burimeve financiare nëpërmjet parashikimeve buxhetore në fillim të vitit. Viti 2016 ka shënuar serish një vit të rëndësishëm në rolin mbështetës dhe nxitës të AMA-s, lidhur me zhvillimin e studimeve të tregut audiovizual, si dhe sfidat dhe problemet që procesi i afërm i digjitalizimit sjell për Shqipërinë.

Me fokus procesin e digjitalizimit janë mbajtur gjatë këtij viti studime dhe kërkime që do të ndihmojnë aktorët e përfshirë në këtë proces për sfidat dhe të panjohurat që do hasen gjatë rrugës. Gjithashtu, janë mbështetur financiarisht nga AMA projekte lidhur me trajnime të gazetarëve dhe aktorëve të medias audiovizive, gjithashtu janë ndjekur angazhimet me palët homologe si dhe janë mbajtur trajnime të stafit për rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore.

Në përmbushje të programit të transparencës, në faqen zyrtare të AMA-s, www.ama.gov.al në rubrikën përkatëse të transparencës gjendet informacioni i përditësuar mbi buxhetin vjetor, mbi realizimet për të ardhurat dhe shpenzimet si dhe Informacionin lidhur me procedurat për prokurimet publike të ndjekura nga AMA.

Gjithashtu në faqen zyrtare “web” të AMA-s janë të publikuara të gjitha informacionet në lidhje me strukturën organizative të AMA-s, të dhënat mbi arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë si dhe struktura e pagave për të gjithë nëpunësit e tjerë. *Për vitin raportues pranë AMA-s kanë ardhur rreth 140 (njëqind e dyzetë) kërkesa, të cilat gjendet të pasqyruara edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të autoritetit, www.ama.gov.al nën Rubrikën Veprimtari/Transparenca, ku janë përfshirë edhe kërkesat për kryerjen e shërbimeve nga ana autoriteti.*

2. QEVERISJA E AUTORITETIT

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka misionin të sigurojë që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kombin, gjuhën, traditën, besimet fetare, kulturën dhe moralin qytetar, në përputhje me vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes dhe medias. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij AMA i përkushtohet veçanërisht respektimit të të drejtave morale dhe ligjore dhe kërkesave për mbrojtjen e të miturve.

Si një autoritet i pavarur rregullator në sektorin audioviziv, AMA është i përkushtuar t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes rregullimit, mbështetjes dhe nxitjes së tregut audioviziv, në mënyrë që shërbimet audiovizive të pasqyrojnë, sa më mirë të jetë e mundur, vlerat, aspiratat dhe identitetin kombëtar shqiptar. Në rolin e tij si rregullator, AMA nxit mekanizmat që i bëjnë shërbimet audiovizive sa më të aksesueshme të jetë e mundur për popullatën, si nga pikëpamja teknike ashtu edhe ajo teknologjike. Për më tepër, AMA investohet që përmbajtja e ofruar të jetë në përputhje me dispozitat ligjore, për përmbajtje të paanshme në kuadrin e të drejtës për informim, përkatësi fetare dhe politike, personalitet, dinjitet, të drejta dhe liri të tjera themelore të njeriut, duke i mundësuar kështu publikut të krijojë opinionin e vet të lirë.

Me vendimin nr. 52 datë 22.7.2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, u zgjodh anëtari i shtatë i AMA-s. Gjithashtu, me vendimin nr. 51 datë 22.7.2016 u rizgjodh në pozicionin e anëtarit të AMA-s, znj. Suela Musta, me vendimin nr. 49 datë 22.07.2016 z. Zylyftar Bregu, dhe me vendimin nr. 50 datë 22.7.2016 z. Sami Nezaj. Në mbledhjen e datës 06.09.2016, me vendimin nr. 181 z. Sami Nezaj u rizgjodh Zëvendëskryetar i AMA-s. Në këtë mënyrë u plotësuan vendet vakante të AMA-s duke shmangur situatat bllokuese me të cilat është përballur AMA, gjatë viteve të mëparshme.

Gjatë vitit 2016, janë zhvilluar 15 mbledhje të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Anëtarët kanë marrë pjesë në çdo mbledhje, me përjashtim të mbledhjes së datës 29.12.2016, ku z. Zylyftar Bregu ka munguar.

Në përforcimin e qeverisjes dhe zhvillimit të tij si një autoritet, efikas dhe llogaridhënës, i angazhuar ndaj standardeve të larta të qeverisjes institucionale është miratuar rregullorja e Autoritetit të Mediave Audiovizive me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016. Kjo rregullore përcakton norma të zbatueshme për mbledhjen, ushtrimin e veprimtarisë, votimin dhe zbatimin e vendimeve të këtij organi kolegjal, në përmbushje të funksioneve që i njeh ligji.

Në datën 27.01.2017 me vendimin nr. 1, Anëtarët e AMA-s, miratuan rregulloren "Për Strukturën Organizative të Autoritetit të Mediave Audiovizive", rregullore e cila synon realizimin në mënyrë të suksesshme dhe të plotë të detyrimeve funksionale që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit.

Gjithashtu me vendimin nr. 56 datë 04.04.2016 të AMA-s, është miratuar Kodi i Sjelljes i Anëtarëve të Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA), i cili është i lidhur ngushtë me rregullimin e veprimtarisë së anëtarëve të AMA-s si dhe administratës, apo bordeve që mund të ngrejë. Ky Kod është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat Audiovizive në Republikën e

Shqipërisë”, dhe ligjit nr.9367, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Kodi Sjelljes vendos rregulla sjelljeje për funksionarët, duke synuar normimin në përputhje me legjislacionin në fuqi të veprimtarisë së tyre, rritjen e etikës në ushtrimin e detyrës, shmangien e rasteve të konfliktit të interesit dhe promovimin e vlerave të institucionit.

Sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ndër kompetencat kryesore të Autoritetit të Mediave Audiovizive, është lëshimi dhe heqja e licencave dhe autorizimeve për ofrimin e shërbimeve mediatike audio/audiovizive. Me qëllim sigurimin e pluralizmit përmes shqyrtimit strategjik të shërbimeve të transmetimit, procedurave të licencimit të OSHMA-ve dhe duke trajtuar me kujdes çështjet e pronësisë dhe kontrollit të kontraktorëve të transmetimit AMA gjatë vitit 2016 ka vendosur:

- Dhënien e licencës për 5 subjekte për transmetime kombëtare private audiovizive;
- Dhënien e autorizimit për 15 subjekte për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv ose për përsëritjen e shërbimit të programit audio dhe/ose audioviziv mbështetur në rrjet kabllor/OTT/IPTV;
- Rinovimin e licencës për transmetime audio për 37 subjekte, rinovimin dhe zëvendësimin e licencës për transmetime audiovizive analoge për 29 subjekte dhe rinovimin e autorizimit për 20 subjekte;
- Mosdhënien e licencës për transmetime audiovizive për 4 subjekte, mosdhënien e autorizimit për 3 subjekte dhe mos rinovimin e autorizimit për 2 subjekte;
- Heqjen e licencës dhe/ose autorizimit për 8 subjekte, konstatimin e pavlefshmërisë së licencës dhe/ose autorizimit për 24 subjekte dhe pezullimin e shqyrtimit të aplikimit për rinovim për 1 subjekt.

Përgjatë vitit raportues në angazhim të përmbushjes së detyrimeve ligjore si dhe rritjes së besimit të publikut ndaj rregullatorit, Autoriteti draftoi strategjinë trevjeçare ku pasqyrohet mënyra e realizimit të funksioneve të veta ligjore. Dokumenti strategjik përmban misionin, vizionin, vlerat, qëllimet strategjike si dhe objektivat përkatëse të AMA-s, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe në parimet mbi të cilat funksionon Autoriteti. Vlerat bazë që formësojnë AMA-n dhe informojnë qasjen e tij ndaj funksionit rregullator janë:

- Motivimi nga interesi publik;
- Të qënurit i drejtë dhe proporcional
- Të qënurit të pavarur dhe të paanshëm
- Llogaridhënës, transparent dhe efikas në kosto

Qëllimet strategjike të AMA-s, për periudhën trevjeçare të strategjisë, ku çdo qëllim përmban objektiva specifike janë:

- Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
- Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies
- Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm në drejtim të përmbajtjeve audio/audiovizive
- Përforcimi i qeverisjes dhe zhvillimi i Autoritetit

Në Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik u planifikuan veprimtaritë me përparësi, si dhe rezultatet e pritshme për përmbushjen e qëllimeve strategjike, të ndara në afate, për periudhën 2017-2019, për të gjitha këto fusha veprimi:

- Kalimi në transmetimet numerike
- Plotësimi i kuadrit ligjor, aktet nënligjore dhe politikat
- Veprimtaritë e Mbikëqyrjes dhe Përputhshmërisë
- Transmetimi dhe promovimi i transmetimit të përgjegjshëm në drejtim të përmbajtjeve audiovizive
- Veprimtaritë e Licencimit
- Komunikimi dhe Zhvillimi Sektorial
- Financat dhe Qeverisja e Autoritetit
- Zhvillimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizative

Gjithashtu, në funksion të projektit për hartimin e Strategjisë, AMA ka ndërmarrë një proces këshillimi publik me grupet e ndryshme të interesit dhe ka përcjellë për mendim dokumentet strategjike Kuvendit, MIAP-it, AKEP-it, Autoritetit të Konkurrencës si dhe ka reflektuar të gjitha sugjerimet e Ministrit për Inovacionin dhe Administratës Publike. Në përmbyllje, në janar të vitit 2017 në kuadër të diskutimit të prioritetëve strategjike për rregullimin e tregut audioviziv por edhe për rritjen e efikasitetit të procesit të këshillimit publik, Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Autoritetin organizuan aktivitetin e përbashkët “Prioritetet strategjike të AMA-s – Këshillimi publik dhe krijimi i partneriteteve si bazë për arritjen e tyre”. Sugjerimet dhe rekomandime pas procesit të konsultimit publik, janë reflektuar në dokumentet strategjike.

Po në këtë vit raportues, Autoriteti ka vijuar punën me përfundimin e procesit të përzgjedhjes të Kryetarit dhe anëtarit të Këshillit të Ankesave, sipas kritereve të përgjithshme dhe të posaçme të përcaktuara me Vendim të AMA-s Nr. 30, datë 16.04.2015. Anëtarët e AMA-s, me vendimin nr. 70 datë 04.04.2016, miratuan me shumicë të cilësuar emërimin në pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Ankesave të znj. Monika Stafa dhe me vendimin nr. 71 datë 04.04.2016 emërimin e anëtarit të këtij këshilli, z. Urim Bajrami.

3. DIGJITALIZIMI

Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive, proces i cili nxit shumëllojshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve audio/audiovizive duke krijuar kushte për zhvillimin e pluralizmit në media dhe garantuar respektimin e plotë të së drejtës së informimit dhe lirisë së shprehjes së individit, është ndjekur me përparësi nga AMA.

Në përmbushje të detyrave të përcaktuara në ligjin 97/2013 dhe strategjinë për kalimin në transmetimet numerike, AMA ka ndërmarrë aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2016 ndër të cilët do të listonim:

- Licencimin e operatorëve privatë kombëtar numerikë. Në tregun audioviziv shqiptar tashmë janë 5 operatorë të licencuar nga AMA për ofrimin e transmetimeve numerike në nivel kombëtar.
- Koordinimin me operatorin publik shqiptar në lidhje me implementimin e dy rrjeteve numerike, si dhe zbatimin e detyrimeve ligjore dypalëshe.
- Koordinimin me operatorët private kombëtare të licencuar për transmetime numerike, lidhur me zbatimin e afateve të implementimit të rrjeteve të tyre numerike sipas përcaktimeve në licencat që ato zotërojnë, procesin e liritimit të frekuencave që përdornin në mënyre të jashtëligjshme, procesin e migrimit të frekuencave si dhe përcaktimin e kushteve dhe kritereve për mbështetjen në rrjetet e tyre të operatorëve lokalë/rajonalë.
- Koordinimin me operatorët analogë lokalë/rajonalë lidhur me afatet kohore të përcaktuara në aktet ligjore të sipërpërmendura për mbështetjen e tyre në rrjetet kombëtare numerike, përfshirë edhe periudhën e simulcast-it (transmetimit njëkohësisht të transmetimeve analoge dhe numerike për një periudhë 1 mujore pas mbështetjes në rrjetet kombëtare); koordinim lidhur me zgjidhjet teknike të parashikuara nga këta operatorë për dërgimin e sinjaleve të tyre pranë Head End-eve të operatorëve kombëtarë, mbi procesin e migrimit të frekuencave etj.
- Organizimi i fushatës informuese për t'iu gjendur pranë publikut deri në përfundim të procesit të digjitalizimit. Fushatë e cila është organizuar në forma të ndryshme për të qenë sa më efektive dhe depërtues tek publiku shqiptar (spote televizive, broshura, fletëpalosje, struktura CallCenter, emisione televizive etj)

Në kuadër të procesit të digjitalizimit, përfaqësuesit e AMA-s kanë qenë pjesë e vendimmarrjeve të rëndësishme të Komitetit Ndërinstitucional të ngritur me Urdhrin nr. 144 të Kryeministrit, datë 7.4.2014, për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë për kalimin në transmetimet numerike si dhe Sekretariatit Teknik, strukturë mbështetëse e Komitetit Ndërinstitucional.

3.1 Licencimi i rrjeteve numerike kombëtare

Pas miratimit të akteve rregullatore për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së *“beauty contest”* dhe përfundimit të procedurave të shqyrtimit të aplikimeve të depozituara për marrje licence private kombëtare audiovizive. AMA, në mbledhjen e datës 01.02.2016, me vendimet nr. 32, nr. 34, nr. 35, ka vendosur mosdhënien e licencës për shoqëritë *“Tv Klan”* sh.a., *“Top Channel”* sh.a., dhe *“Digit-Alb”* sh.a., për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor. Ndërsa me vendimin nr. 33, datë 01.02.2016 ka vendosur mosdhënien e licencës, shoqërisë *“Supersport”* sh.a., pasi aplikimi i tij nuk ishte në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore.

Në vijim, shoqëria *“Digit-Alb”* sh.a., shoqëria *“Tv Klan”* sh.a., dhe shoqëria *“Top Channel”* sh.a., kanë investuar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimeve nr. 32, nr. 34 dhe nr. 35, datë 01.02.2016 të AMA-s.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 80-2016-1028, datë 07.03.2016, ka vendosur ndryshimin e akteve administrative të AMA-s, duke vendosur dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv, shoqërive "Digit-Alb" sh.a., "Tv Klan" sh.a., dhe "Top Channel" sh.a.

Në vijim, AMA me qëllim përshpejtimin e procesit të mbylljes së transmetimeve analoge, me vendimin nr. 218, datë 12.10.2016, miratoi rregulloren "Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv". Në muajin nëntor 2016, AMA shpalli publikisht çeljen e garës për dhënien e 2 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik për rrjetet numerike të identifikuara me nr. 006 K dhe nr. 007 K dhe pranë AMA-s u depozituan 5 aplikime.

AMA pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjektet aplikuese vendosi:

- Dhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv, subjektit shoqërisë "Media Vizion" sh.a.
- Mosdhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv subjektit shoqërisë "ADTN" sh.a.
- Skualifikimin e subjektit aplikues shoqërisë "ABC News" sh.a.
- Skualifikimin e subjektit aplikues shoqërisë "Tring Tv" sh.a.
- Skualifikimin e subjektit aplikues shoqërisë "ORA" sh.a.

Pas marrjes në shqyrtim të kërkesës së depozituar nga subjekti "ADTN" sh.a., AMA në mbledhjen e datës 27.01.2017, miratoi dhënien e licencës kombëtare numerike audiovizive këtij subjekti.

Me dhënien e kësaj licence, u konkludua procesi i licencimit të shtatë rrjeteve numerike kombëtare, dy prej të cilëve i janë akorduar RTSH-së dhe nga një rrjet, subjekteve "Tv Klan" sh.a., "Digit-Alb" sh.a., "Top-Channel" sh.a., "Media Vizion" sh.a. dhe "ADTN" sh.a..

3.2 Digjitalizimi i rrjeteve numerike kombëtare

Ndërtimi i rrjeteve numerike dhe koordinimi me RTSH-në për përmbushjen e detyrimeve ligjore. Procesi i ndërtimit të rrjeteve kombëtare numerike dhe koordinimit për zbatimin e detyrave të përbashkëta AMA-RTSH, në kuadër të procesit të digjitalizimit, ka pasur progres të ndjeshëm. AMA ka luajtur rol nxitës në lidhje me sipërmarrjet e RTSH-së pasi gjatë gjithë vitit 2016 janë organizuar një sërë takimesh, kemi shkëmbyer korrespondenca të vazhdueshme dhe kemi bashkëpunuar në kuadër të gjetjes së zgjidhjeve ligjore dhe teknike për çështjet që lidhen me digjitalizimin.

Takimet e organizuara me përfaqësi në nivele drejtuese apo nivele teknike si dhe grupi i përbashkët i punës AMA-RTSH, i ngritur për ndjekjen e çështjeve që lidhen me procesin e digjitalizimit, kanë pasur në fokusin e tyre diskutimin e çështjeve të mëposhtme:

- Përcaktimin e fazave të implementimit të dy rrjeteve numerike të RTSH-së, me qëllim koordinimin me operatorët private kombëtare si dhe operatorët lokalë/rajonale për mbështetjen e tyre në rrjetin e parë të RTSH-së.
- Përcaktimin e vendndodhjeve të pikave të lidhjes midis RTSH-së dhe subjekteve lokalë/rajonale në çdo allotment, në mënyrë që zgjidhjet të ishin sa më efektive dhe me pak kosto për operatorët lokalë/rajonale.
- Përcaktimin e kapacitetit teknik që do të vihej në dispozicion të operatorëve lokalë/rajonale nga ana e RTSH-së, në mënyrë që të bëhej e mundur mbështetja e programeve të një numri të konsiderueshëm të operatorëve lokalë/rajonale dhe njëkohësisht të sigurohej cilësia e sinjalit.
- Përcaktimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, programore, teknike dhe financiare që duhet të përfshiheshin në kontratën e shërbimit që lidhet midis AMA-s dhe RTSH-së, duke u finalizuar me miratimin e saj nga AMA.
- Përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të kontratës tip që lidhet midis RTSH-së dhe operatorëve lokalë/rajonale.

Gjithashtu, AMA ka organizuar takime konsultative edhe me operatorët televizivë lokalë dhe rajonale me fokus kryesor problematikat e mbështetjes së tyre në rrjetin e RTSH-së. Shqetësim nga këta operatorë ka qenë tarifa që duhet të paguajnë duke pretenduar se është shumë e lartë dhe kanë shprehur kërkesën që të paktën për vitin e parë të subvencionohen nga shteti.

Operatori publik shqiptar ka filluar transmetimet numerike në qarqet Tiranë dhe Durrës më datë 1 dhjetor 2016 dhe tashmë ka ndezur sinjalin numerik edhe në qarqet Lezhë, Fier, Berat dhe Dibër. RTSH ka ndërtuar infrastrukturën fizike edhe në qarqe të tjera të vendit, gjë që do të sjellë përshpejtimin e finalizimit të procesit të digjitalizimit, pasi ndërtimi i rrjeteve të RTSH-së është i një rendësie të veçantë duke njohur faktin se njëri nga rrjetet e saj do të shërbejë si mbështetje për programet e operatorëve lokalë/rajonale.

3.3 Digjitalizimi i rrjeteve analoge të operatorëve ekzistues

Në dispozitat kalimtare të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se subjektet televizivë analogë private vendore kanë të drejtë të mbështetjen programet e tyre në rrjetin numerik të televizionit publik ose rrjetet e tjera numerike private kombëtare të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013.

Referuar sa më sipër, AMA ka kërkuar nga subjektet ekzistues analogë lokalë/rajonale të qarqeve Tiranë, Durrës, ku operatorët kombëtarë numerikë kanë filluar transmetimet numerike, që të depozitohen kontratat tip të lidhur me njërin nga këta operatorë (publik apo private). Aktualisht janë depozituar kontratat nga 5 operatorë audiovizivë edhe pse nga RTSH informohemi se deri tani kanë lidhur marrëveshjen vetëm 10 nga 22 operatorë. Konsiderojmë që ka filluar procesi i mbartjes së operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë, Durrës) edhe pse kontratat e paraqitura janë të pakta në numër në krahasim me numrin e operatorëve që ofrojnë transmetime audiovizive në allotmentin e Tiranës.

Ndërkohë, AMA është duke njoftuar zyrtarisht operatorët privatë lokalë/rajonale të qarqeve Lezhë, Fier, Berat dhe Dibër të depozitojnë kontratat/marrëveshjet e lidhura me operatorët kombëtarë.

3.4 Kontrata AMA- RTSH

Kontrata e shërbimit të transmetimit publik konsiderohet si akti që rregullon marrëdhënien midis AMA-s, si autoritet rregullator për transmetimet audiovizive dhe RTSH-së, si operatori publik, misioni i të cilit është informimi, edukimi dhe argëtimi i publikut, përfshirë pakicat kombëtare. Përgjatë periudhës raportuese, midis AMA-s dhe RTSH-së ka pasur komunikim të vazhdueshëm shkresor sa i përket draftimit të kontratës së shërbimit të transmetimit publik.

Pasi është përfunduar procesi i këshillimit publik, kryer prej RTSH-së, ky i fundit, në muajin nëntor 2016, ka depozituar në AMA, kontratën e nënshkruar të shërbimit të transmetimit publik. Në vijim, AMA ka bërë propozime dhe komente mbi projekt kontratën e hartuar nga RTSH. Komentet dhe sugjerimet e AMA-s, konsistojnë në saktësimin e disa dispozitave të kontratës lidhur me rrjetet e transmetimit të RTSH-së dhe katalogun e programeve. Po ashtu, është propozuar të rregullohet në kontratë mënyra e raportimit të operatorit publik tek AMA, sa i përket bilancit vjetor dhe prodhimet e porositura nga fondi i prodhimit të pavarur.

Këshilli Drejtues i RTSH-së, me vendimin nr. 18, datë 31 janar 2017 ka miratuar kontratën e shërbimit të transmetimit publik dhe ka kërkuar miratimin nga AMA.

AMA, pas një vlerësimi në tërësi të dokumentit në frymën e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatoi se dokumenti i ri propozuar për miratim është në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 97/2013, të sipërcituar dhe me vendimin nr. 18, datë 02.03.2017, miratoi kontratën e shërbimit të transmetimit publik.

Në këtë kontratë gjejnë rregullim çështjet ligjore, teknike, programore dhe financiare të marrëdhënies AMA-RTSH dhe parashikohen natyra dhe numri i orëve të programeve për të miturit, programet e transmetimit për shkencën dhe teknologjinë. Pjesë e kontratës së shërbimit të transmetimit publik është përcaktimi i kriterëve dhe masave rregulluese për bashkë përdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së, lista e programeve audiovizive të RTSH-së, infrastruktura e transmetimit të RTSH-së si dhe përcaktimi i masave për të siguruar akses në informacion nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

3.5 Procesi i migrimit të frekuencave

Procesi i digjitalizimit shoqërohet me procesin e migrimit të operatorëve të licencuar nga AMA për transmetimet analoge nga frekuencat që kanë në përdorim, te cilat janë planifikuar për ndërtimin e rrjeteve numerike kombëtare në frekuenca të tjera jashtë planit numerik kombëtar.

Në këtë kuadër, AMA ka hartuar planin e migrimit të frekuencave në të cilin janë përcaktuar frekuencat që do t'i vihen në dispozicion operatorëve lokalë dhe rajonalë për të transmetuar për një periudhë kohore deri në mbështetjen e tyre në rrjetet kombëtare numerike si dhe frekuencat për operatorët kombëtarë për një periudhë kohore deri në ndërtimin e rrjeteve të tyre numerike.

AMA është përballur me vështirësi për përcaktimin e frekuencave në qarqet Tiranë, Durrës për shkak të numrit të madh të operatorëve që ka në këto qarqe, padisponueshmërisë së frekuencave për të kryer migrimin por sidomos nga zënia tyre në mënyrë të jashtëligjshme nga disa operatore vendore. Migrimi në allotmentin e Tiranës (qarqet Tiranë, Durrës) është bërë i mundur vetëm pas lirimit të frekuencave që përdorshin në mënyrë të jashtëligjshme nga operatorët audivizivë në këtë allotment.

Zënia në mënyrë të jashtëligjshme e frekuencave televizive nga disa operatorë kishte sjellë mungesën e frekuencave të lira për kryerjen e procesit të migrimit drejt frekuencave të përcaktuara sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe në përputhje me Marrëveshjen Ndërkombëtare të Gjenevës06.

Për më tepër, operatorët kombëtarë kanë shprehur në mënyrë të përsëritur në AMA, ankesa lidhur me zënien e frekuencave që u takojnë sipas licencës së lëshuar nga AMA që në prill 2016, pasi sillte pengesë në implementimin e rrjeteve të tyre kombëtare numerike. Në ankesat e paraqitura argumentohen dëmet financiare që rrjedhin nga vonesat në implementimin e rrjeteve numerike nisur nga fakti që operatorët kombëtarë paguajnë detyrime financiare për frekuencat që ende si kanë marrë në dorëzim, detyrime që rezultojnë në shumën totale prej 27,600,000 lekësh. Këto ankesa janë përshkallëzuar deri në deklarime për ndërprerjen e pagesave për detyrimet financiare mbi frekuencat deri në momentin e alokimit të plotë të tyre sipas kushteve të licencës.

Nisur nga shqetësimet e theksuara më sipër, AMA ka njoftuar zyrtarisht në datat 09/11, 01/12 dhe 28/12 të vitit 2016 të gjithë operatorët ofrues të shërbimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë të cilët emëtojnë nga pika transmetimi dhe frekuenca të paautorizuara, që të marrin masat e duhura për lirimin e frekuencave të zëna arbitrarisht dhe pa licencë brenda datës 31/12/2016. Gjithashtu, ka organizuar takim të posaçëm me operatorët kombëtarë numerik (publik dhe privat) të licencuar nga AMA dhe operatorët që kishin okupuar frekuencat në mënyrë të jashtëligjshme në qarqet Tiranë, Durrës, për të shpjeguar situatën aktuale dhe detyrimet ligjore që duhen zbatuar nga të gjithë aktorët në tregun audiovizivë. Gjatë procesit të lirimit të frekuencave, AMA ka hasur në rezistencën e disa operatorëve (Ora News, Tring TV) ndërkohë që i janë përgjigjur pozitivisht operatorët e tjerë News 24, Top Channel dhe Shijak TV.

Aktualisht është bërë i mundur lirimi i frekuencave të përcaktuara për ndërtimin e rrjeteve numerike kombëtare në qarqet Tiranë, Durrës, Shkodër dhe migrimi i operatorëve audivizivë që kanë pasur në përdorim këto frekuenca në frekuenca të tjera jashtë planit numerik.

Procesi i migrimit të frekuencave, do të vijojë të ndiqet nga AMA deri në përfundimin e plotë të procesit të digjitalizimit, allotment pas allotmenti, bazuar në disponueshmërinë e frekuencave të lira.

3.6 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital

Lirimi i frekuencave të brezit 790-862 MHz (DD1), ka qenë shqetësim i vazhdueshëm i AMA-s për shkak të interferencave të dëmshme që shkaktonin operatorët audiovizivë shqiptarë në vendet fqinjë, të cilët tashmë e përdorin këtë brez për ofrimin e shërbimeve mobile dhe kanë adresuar ndaj autoriteteve shqiptare ankesa të përsëritura deri dhe në marrjen e masave dhe sanksioneve të parashikuara kundrejt mos respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me administrimin e brezit frekuencor.

Për më tepër, brezi DD1 është brez i cili është parashikuar në Planin Kombëtar të Frekuencave për ofrimin e shërbimeve të lëvizshme dhe në fillim të këtij viti AKEP ka nisur procedurën e Këshillimit Publik mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezit 800 MHz.

Si rrjedhojë, lirimi i frekuencave të brezit DD1 përbënte emergjencë për AMA dhe në kuadër të zgjidhjes së problematikave të lartpërmendura ka ndërmarrë disa hapa për lirimin e këtij brezi ku do të theksonin:

- Njoftimin e dërguar të gjithë operatorëve që transmetojnë në mënyrë të jashtëligjshme në brezin DD1, duke përcaktuar si afat përfundimtar datën 31.12.2016.
- AMA ka hasur vështirësi në zbatimin e afateve të kërkuara nga disa operatorë dhe ka ndërmarrë e po vijon të ndërmarrë të gjitha masat e parashikuara në ligj për lirimin e plotë të frekuencave të zëna arbitrarisht.
- Njoftimin dërguar operatorëve analogë të cilët kanë në përdorim frekuencat e brezit DD1, për migrimin e tyre në frekuenca të tjera jashtë këtij brezi, duke përcaktuar afate të ngushta për lirimin e tyre. Shkresat zyrtare i janë dërguar gjithsej 14 operatorëve audiovizivë, që kanë në përdorim kanalet e brezit DD1.
- Monitorimet e kryera për verifikimin lidhur me lirimin e frekuencave të brezit DD1.

Në sajë të aktiviteteve të sipërcituara janë liruar disa kanale të brezit DD1 në zonat kufitare të vendit duke bërë kështu të mundur shmangien e interferencave të shkaktuara nga operatorët audiovizivë shqiptar në rrjetet mobile të këtyre vendeve (sikurse me Malin e Zi).

Ndërkohë po vijon me intensitet puna për lirimin e të gjitha kanaleve që i përkasin këtij brezi duke bërë të mundur lirimin e plotë të tij brenda datës 30 qershor 2017, datë e cila është përcaktuar si afati përfundimtar për lirimin e brezit DD1 nga Komiteti Ndërinstitucional për zbatimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike.

3.7 Fushata e informimit të publikut

Një nga pikat që i del si detyrë Autoritetit nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nga Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike është edhe fushata për informimin e publikut në vazhdimësi në lidhje me këtë proces dhe transmetimet e reja.

Koordinimi me operatorët lidhur me procesin e digjitalizimit - AMA që në fillim të herës dhe çeljes së procesit të digjitalizimit i ka konsideruar operatorët vendorë, njëlloj si teleshikuesit pjesë shumë e rëndësishme e nisjes, zhvillimit dhe përfundimit me sukses të procesit.

Më 19 shkurt 2016 AMA organizoi një takim konsultativ me operatorët analogë privatë vendorë për diskutimin e tarifës së mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së. AMA duke pasur të ftuar edhe nga RTSH drejtoi diskutimin mbi tarifën që këtyre operatorëve do t’i duhet të paguajnë për mbështetjen e programeve të tyre në rrjetin numerik të televizionit publik. Ne përputhje me propozimin e AMA-s, tarifa e propozuar nga RTSH konsideronte vetëm zërat financiarë që lidhen me mirëmbajtjen e rrjetit numerik duke mos përfshirë kostot e ndërtimit të rrjetit, sic Propozohet në Strategji, duke ulur kështu tarifën deri në tre here.

Gjatë takimit u diskutua edhe propozimi i RTSH-së mbi diferencimin e tarifave për allotmente të ndryshme, ku për allotmentin e Tiranës do të aplikohet dyfishi i tarifës, për zonat bregdetare dhe Korçës do të aplikohet 1.5 e tarifës dhe për zonat e tjera 0.5 e tarifës së propozuar

Po në këtë vazhdë AMA ka organizuar konsultë informuese me operatorët e allotmentit Tiranë-Durrës për procesin e digjitalizimit në shtator 2016. Takimi ishte organizuar në formën e një *workshop*-i dhe operatorët patën mundësi të shtronin pyetjet e tyre për problematika që i shqetësojnë drejtpërsëdrejti. Për t’i dhënë një përgjigje sa më të plotë, bashkë me përfaqësues të AMA-s, në takim ishin edhe përfaqësues nga Radiotelevizioni Shqiptar dhe Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike. Një nga pikat kryesore të takimit ishte edhe tarifa e përcaktuar nga RTSH dhe miratuar nga AMA në lidhje me mbështetjen e operatorëve vendorë në rrjetin e Operatorit Publik. Tarifa mujore për mbështetjen në një allotment, do zbatohet për jo më shumë se 1 vit, ndërkohë që për vitet pasardhëse AMA do të shprehet me vendim duke u bazuar në vlerësimin e zërave financiarë që do të pasqyrohen në situatën reale të operimit të rrjetit numerik tokësor gjatë vitit të parë. Tarifa e mbështetjes në rrjetin e RTSH, në allotmentin Tiranë-Durrës, gjatë vitit të parë do të jetë 2146 Euro dhe për vitet pasardhës tarifa do të përlllogaritet bazuar në të dhënat faktike të mirëmbajtjes së rrjetit. Operatorët vendorë privatë të allotmentit Tiranë-Durrës që do të zgjedhin të mbështeten në rrjetin e RTSH-së do të mund të transmetojnë programet e tyre nga 9 pika transmetimi të instaluar në këto qarqe.

Pjesëmarrësit u informuan gjatë takimit edhe për çështje të ndryshme ligjore, teknike, programore dhe financiare, në kuadër të procesit të kalimit në transmetime numerike si dhe për mbështetjen e tyre në rrjetet që RTSH është duke ndërtuar. Operatorët nga ana e tyre ngritën shqetësim në lidhje me zonat e mbulimit, detyrimet financiare, llojin e dekoderave dhe mënyrën që është menduar për shpërndarjen e tyre për familjet në nevojë dhe paqartësira të tjera teknike.

Intervistat speciale në radio e televizione- AMA që nga fillimi i muajit shtator deri në fund të muajit dhjetor 2016 ka zhvilluar 272 emisione radiofonike dhe televizive në radiot dhe televizionet

kryesorë të vendit. Të ftuar në këto emisione kanë qenë specialistë dhe ekspertë të fushave të ndryshme të AMA-s. Qëllimi i këtyre emisioneve ishte shpjegimi i saktë i procesit të digjitalizimit, mënyrës sesi po bëhet kalimi i transmetimeve dhe shumë detaje të tjera teknike, programore dhe juridike të procesit. Me të njëjtin fokus dhe në të njëjtin kuadër janë zhvilluar edhe disa reportazhe në zyrat e Autoritetit, të cilat po ashtu janë transmetuar në media.

Struktura call center- Që prej muajit prill të vitit 2016, AMA ka vënë në dispozicion numrin e Call Center (04-410-44-55 dhe 04-410-44-56) këto dy numra janë në dispozicion të të gjitha pyetjeve nga ora 9.00 deri në orën 21.00. Në total janë pritur 3500 telefonata.

Broshurat- Broshura informuese ka si qëllim që të mbërrijë në të gjitha institucionet, organizmat, operatorët audiovizive dhe te gjitha palët me të cilët AMA bashkevepron ne funksion te zbatimit te detyrave te parashikuara ne kuadrin ligjor. Informacioni në broshurë është i thelluar dhe ajo përmban informacion për procesin në tërësi, për aspektet teknike, si për përfitimet që teleshikuesi do të ketë me aplikimin e këtij procesi. Gjithashtu në këto broshura përmenden edhe risqet dhe masat që secili duhet të marrë që të ketë sinjal televiziv pa ndërprerje. Broshura përmban informacione mbi dekoderat dhe mbi televizorët që duhet të jenë në përdorim pasi që të ndodhë kalimi në transmetimet numerike.

Broshura do t'u drejtohet gjithashtu përdoruesve, dhe transmetuesve, sidomos atyre lokalë, gazetarëve dhe studiuesve, organizatave jo fitim prurëse të cilat kanë interes në fushën e informimit dhe mund të ndihmojnë në përhapjen e informacionit. Në total janë shpërndarë 1200 broshura.

Fletëpalosjet - Informacioni që përmban fletëpalosja është i orientuar mbi konsumatorin fundor. Fletëpalosja i drejtohet përdoruesit që do të jenë trageti i komunikimit dhe ka si qëllim që të hyjë në secilën familje shqiptare. Fletëpalosja ka qëllim edukimin e konsumatorit me teknologjitë e reja. Deri tani janë shpërndarë 300,000 fletëpalosjet derë më derë.

Spotet në radio dhe televizion - Spotet televizive dhe radiofonike janë përgatitur për të njoftuar audiencën mbi procesin e digjitalizimit, për të dhënë detaje mbi dekoderat që secili duhet të blejë për të parë transmetime digjitale, pasi të ndërpriten ato analoge. Spotet janë duke u transmetuar që nga mesi i muajit prill 2016 në radio dhe televizionet kryesore në vend me qëllim njoftimin e procesit, dhënien e detajeve teknike praktike për blerjen e dekoderave dhe televizorëve, lidhjet mes tyre etj.

Rubrika "Digjitalizimi" në web faqen zyrtare te AMA-s Në faqen zyrtare të Autoritetit në web AMA nxjerr njoftime dhe mban të informuar në kohë reale të gjitha palët e interesuara në lidhje me çfarë ndodh në lidhje me procesin. Në rubrikën "Digjitalizimi" palët e interesuara gjejnë informacion te detajuar mbi procesin e digjitalizimit, si kuadrin rregullator, planin numerik frekuencor, të dhëna të përgjithshme, broshurën e përgatitur, fletëpalosjen e përgatitur, kontaktet të strukturës Call Center, linkun që të çon direkt në faqen e rrjetit social facebook të AMA-s si dhe të gjitha intervistat e emisioneve speciale mbi digjitalizimin e transmetimeve audiovizive.

Adresa Email zyrtare e Autoritetit: në adresën zyrtare të Autoritetit info@ama.gov.al vijnë, ndër të tjera, edhe pyetje të rastësishme të qytetarëve në lidhje me digjitalizimin e transmetimeve. Sipas specifikës së pyetjes, ajo i dërgohet për përgjigje drejtorisë përkatëse e cila pergatit përgjigjen brenda afateve të përcaktuara nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Faqja e facebookut të Autoritetit “Autoriteti i Mediave Audiovizive – Digjitalizimi”: në faqen facebook të Autoritetit “Autoriteti i Mediave Audiovizive – Digjitalizimi”, publikohen të gjitha informacionet në lidhje me procesin. Po ashtu, të gjitha pyetjeve që vijnë në postën private të kësaj adrese marrin përgjigje me të njëjtën procedurë si ato që vijnë në adresën info@ama.gov.al. Theksojmë se AMA do të vijojë me informimin e publikut mbi procesin dhe zhvillimet e tij deri në momentin ku transmetimet digjitale të jenë aktive në të gjithë territorin e vendit.

4. KËSHILLI I ANKESAVE

Këshilli i Ankesave është krijuar si njësi në strukturën organizative të Autoritetit në përmbushje të kërkesave ligjore për funksionimin e tij. Ai ka për qëllim analizimin e etikës së komunikimit audioviziv, raportet e së drejtës për informim dhe së drejtës për privatësi, për përparësinë e mbrojtjes së interesit publik dhe respektimin e dinjitetit të individit. Objekt i punës për Këshillin e Ankesave është gjithashtu, mbikëqyrja e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë kryesisht me respektimin e dinjitetit e të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

Këshilli i Ankesave, gjatë vitit raportues ka qenë dhe vijon të jetë një organ i angazhuar thellësisht në shërbim të të gjitha OSHMA-ve dhe publikut të gjerë, duke kërkuar të jetë transparent, i hapur e i drejtë ndaj çdo vërejtje apo paralajmërimi përballë shkeljeve që i bëhet Kodit të Transmetimit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA. Këshilli i Ankesave ka qenë i gatshëm të ofrojë një mundësi për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit të tij, duke u fokusuar dhe tek hapësirat problematike gjatë procesit të punës së tij. Këshilli i Ankesave është përqasur për të ushqyer këtë refleksion nëpërmjet komunikimit transparent dhe të drejtë me opinionin publik, palëve të prekur dhe subjekteve audiovizive.

Në moton e tij të punës se një fuqizim i komunikimit dhe një përmirësim në rritje i bashkëpunimit me aktorët e tjerë të influencës i pajis qytetarët me më shumë ndërgjegje morale këshilli i Ankesave nuk ka lejuar ndërhyrjen e argumenteve të pa vlerë që ngjasin në dilemat etike dhe ka gjetur vend përherë tradita më e mirë e filozofisë praktike duke u prirur të pasurojë opinionin publik me sa më shumë dije për etikën dhe duke i aftësuar qytetarët për t’u vetë edukuar lidhur mbi parimet kryesore të saj. Këshilli i Ankesave ka synim të nxisë kulturën e etikës dhe të vëzhgimit ndaj operatorëve duke mënjanuar gjuhën e ashpër të ndërmjetësimit mes institucioneve dhe duke dhënë shembullin e një modeli rregullator mes palësh të standardeve

European. Duke pasur në këtë mënyre rolin e rregullatorit në pikën më frontale të problemeve, atje ku dhe opinioni publik është tejet i ndjeshëm ndaj shkeljes së parimeve dhe rregullave etike, si çënimi i privatësisë, dinjitetit dhe personalitetit të tij apo dhe sa i përket tabuve të sjelljeve seksuale

Hartimi i rregulloreve mbi procedurat për trajtimin e ankesave nga OSHMA-të dhe ushtrimi i së drejtës së përgjigjes ka qenë prioritet i Planit të Punës së Këshillit të Ankesave në gjashtë-mujorin e parë të aktivitetit të tij. Objekti dhe qëllimi i kësaj rregulloreje përcakton dhe procedurat që duhet të ndiqen për trajtimin e ankesave lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Aty është përshkruar edhe procedura për trajtimin e ankesave nga OSHMA-të, e cila duhet të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person fizik ose juridik për programet e transmetuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 të këtij ligji, mbi cilësinë e shërbimit të ofruar ose përbushjen e detyrimeve kontraktore për shërbimet me abonim. Po ashtu është hartuar dhe manuali mbi procesin e brendshëm të regjistrimit dhe trajtimit të ankesave.

Ndërtimi i një seksioni të posaçëm në web-in e AMA-s mbi ankesat nga publiku dhe subjektet ka qenë një ndër pikat e para të Planit të Veprimit qysh ditët e para të vënies në funksion me kohë të plotë të zyrës së KA-së. Seksioni përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për realizimin e ankesës, detyrimet ligjore të palëve, të shkruara në një formë të thjeshtë. Qëllimi i udhëzimeve ka të bëjë me ndihmën që Këshillit të Ankesave i vjen duke identifikuar praktikën më të mira dhe karakteristikat kryesore të një sistemi sa më efektiv të ankesave. Përvoja më e mirë është kur vetë operatorët radioteleviziv ngrenë sistemin e ankesave në mjediset e tyre që u vijnë në drejtim të programeve të ndryshme referuar gjithmonë Kodit të Transmetimit. Këto udhëzime do të jenë veçanërisht të dobishme për ta, sa i përket vlerësimeve të ardhshme mbi veprimin e procesit të ankesave.

Gjithashtu, Buletini i Këshillit të Ankesave i cili prej disa kohësh ka qenë i munguar në tregun audioviziv si këshillues i përmbajtjes së programeve audiovizive, është dokumenti zyrtar i hartuar dhe botuar në të cilin u raportuan rezultatet e ankesave të shqyrtuara nëpërmjet të cilave dyshohet se janë shkelur parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë për vitin 2016. Nga shqyrtimi i tij del se pavarësisht nga progresi i pamohueshëm i zhvillimeve në tregun audioviziv, çënimi i normave dhe rregullave të etikës nuk kanë munguar. Ajo që konstatohet duket se vetë gazetarët janë në dijeni të situatës, por atyre u mungon nxitja dhe dëshira për ta përmirësuar atë. Në mënyrë të ngjashme, po aq edhe pronarët e medias, nuk duket të jenë veçanërisht të interesuar në nxitjen e zbatimit të standardeve të vendosura. Në shumë prej tyre nuk ekzistojnë as formacionet me bordet e tyre etike të këshillimit, si rregullator ndaj veprimtarisë gazetareske apo editoriale të përmbajtjes së programit edhe pse funksionimi i tyre krijon mundësinë e zbatimit më me rigorozitet të Kodit të Transmetimit të AMA-s, dhe ligjit për mediat.

Në adresën e Autoritetit të Mediave Audiovizive që prej muajit prill kanë mbërritur shumë ankesa, shumica prej të cilave kanë pasur për subjekt çështjen e trajtimit të të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive. Dhjetra reagime lidhur me këtë temë kanë mbërritur

sidomos nga rrjetet sociale, konsiderueshëm edhe nga institucione publike dhe organizata joqeveritare. Ankesat e tjera në lidhje me cenimin e normave etike kanë pasur një numër më të ulët. Çështja e publikimit të të dhënave sensitive të fëmijëve ka qenë ndër shqetësimet e vazhdueshme në trajtimin e ankesave me përmbajtje të tillë nga Këshilli i Ankesave.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në mjedisin e sotëm të transmetimeve audiovizive mbetet një shqetësim i veçantë dhe përfaqëson një sfidë jo pak të lehtë. Në veçanti këto kërkesa shtrohen para transmetuesit publik tek i cili besimi për të ofruar një shërbim me përmbajtje vlerash dhe normash, ka pasur gjithmonë një pritshmëri më të lartë. Nisur prej cenimit herë pas here të të drejtave të fëmijëve në transmetuesit audiovizivë apo dhe shkeljeve që janë shënuar sa i përket të drejtës së privatësisë dhe të tjerave që kanë përbërë po aq cënim të rregullave etike sa i përket moralit në shoqërinë shqiptare, për Këshillin e Ankesave kanë përbërë shqetësim sa i përket zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi.

Edhe pse nuk duhet hequr nga vëmendja se çështja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nuk është vetëm ndër marrja e disa masave teknike, as edhe e sanksioneve të forta ligjore për t'i mbrojtur ata prej disa të drejtave që gëzojnë dhe që ruhen me ligje ndërkombëtare por ka më shumë se kaq. Është një kombinim kërkesash i autoriteteve rregullatorë që bazohen tek prodhimi i përmbajtjes së duhur që emetohen në to, edukimi cilësor mbi median digjitale dhe ndarja e përgjegjësive mes aktorëve të ndryshëm. Në këtë rast bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm.

Nisur prej përvojave më të mira të rregullatorëve, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Këshilli i Ankesave në veçanti, janë të prirur me gjithë përshkrimin e kësaj situatë më lart, të nxisin disa aktorë për t'u përfshirë në diskutimin e mundësive për të krijuar një praktikë efektive të vetë-rregullimit të situatës etike në tregun audioviziv. Me gjithë vështirësitë dhe pengesat që hasen rrugës për shkak të një tregu jo fort konvergjent referuar parimeve etike mes palëve, përpjekjet kohët e fundit kanë pasur një natyrë insistuese, energjike dhe të bashkërenduar me aktorë të tjerë, në përmirësimin e situatës sa i përket ndërgjegjësimit të saj.

Ne plotësim të detyrave funksionale të tij, Këshilli i Ankesave ka kërkuar një anketim mbi performancën e Kodit të Transmetimit Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës zbatimin e metodologjisë mbi hulumtimin e tregut për të përcaktuar qëndrimet e publikut ndaj një sërë çështjesh me rëndësi dhe tepër sensibilisuese për të.

Për të pasur një rezultat sa më afër të vërtetës reale lidhur me performancën e Kodit të Transmetimit nga ana e subjekteve audiovizive, metodologjia e këtij anketimi u mbështet kryesisht në parimin e krahasimit dhe kryqëzimit të të dhënave. Duke rikujtuar se Këshilli i Ankesave (KA) pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) është "gardiani" i mbrojtjes së etikës në transmetimet audiovizive, edhe kjo pjesë e anketimit merr rëndësi të veçantë, jo vetëm si pjesë e së tërës, por edhe duke u plotësuar më tej me pika të nxehta të debatit të sotëm mbi mediat, ku në fokus janë emisionet - e jo vetëm emisionet - që cenojnë psikologjinë dhe edukatën e fëmijëve apo keqpërdorimi i imazhit të fëmijëve në ekran, përkundër anës tjetër të medaljes, nëse ka bollshëm emisione argëtuese për fëmijët në ekranet shqiptare.

Për të marrë një perceptim sa më realist, anketimi u shtri në të dyja gjinitë (femra-meshkuj), në disa nivele arsimimi (tetëvjeçar, të mesëm, universitar dhe pasuniversitar) si dhe në tri grup

mosha (18-34 vjeç; 35-49 dhe mbi 50 vjeç). Sigurisht që me këtë shtrirje të anketës në tri rrafshë nuk është synuar thjesht marrja e përgjigjeve të diversifikuara, por edhe e një pamjeje mbi gjendjen e medias shqiptare, lirinë e gazetarëve, emisionet televizive dhe problemet që shfaqen në to, përmes disa këndvështrimeve: gjinore, të nivelit arsimor dhe atij moshor.

Anketa, rezultatet e së cilës janë publikuar tashmë së bashku me buletin e ankesave, synoi të sigurojë një perceptim tërësor mbi situatën aktuale të medias në Shqipëri, e në veçanti mbi punën e gazetarëve; lirinë që ata kanë për t'u shprehur; raportin e ekranit me qytetarët dhe aksesin e këtyre të fundit, interferencat politike në televizione, etj. Një pikë e rëndësishme e anketimit ishte dhe thithja e mendimeve/ perceptimeve mbi shkelje të mundshme të Kodit të Transmetimit në programet televizive, pra nëse ka apo jo fyerje, shpifje dhe cenim dinjiteti, dhe nëse ka, në ç'shmallë janë ato shkelje.

5. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

5.1 Shqyrtimi analitik i përmbajtjeve të emetuara

Tipare të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të - Tre kanë qenë drejtimet kryesore ku janë orientuar gjatë vitit 2016 shqyrtimet analitike për përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të, për përputhshmërinë me ligjin 97/2013 dhe Kodin e Transmetimit të AMA-s:

- respektimi i të drejtave të miturve nga OSHMA-të, në mënyrë të veçantë të Televizioni Publik Shqiptar, TVSH;
- menaxhimi i hapësirës së reklamave dhe komunikimeve me natyrë tregtare;
- hapësira që OSHMA-të kombëtare ju lënë veprave evropiane.

a) Mbrojtja e të miturve dhe prezenca e tyre në programet audiovizive

Duke e konsideruar mbrojtjen e të miturve në transmetimet audiovizive si dhe mbulimin e tematikës që lidhet me ta si një ndër prioritetet për Autoritetin, gjatë muajit prill 2016 u zhvillua një shqyrtim analitik mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve në programet informative të katër televizioneve TVSH, Klan, Top Channel dhe Vizion Plus. Impakti dhe rëndësia që kanë tek audiencia operatorët kombëtarë audiovizivë në panoramën mediatike shqiptare dhe drejtpërdrejt tek audiencia, të ndërthurura dhe me misionin e detyrimin e OSHMA-ve për mbrojtjen, edukimin dhe forcimin e shëndetit mendor e moral të fëmijëve synoi:

- evidentimin e problematikës së programeve informative;
- llojet e rubrikave të lajmeve ku shfaqen më dendur shkeljet e kërkesave ligjore dhe etike për fëmijët
- paraqitjen e rasteve tipike të mosnjohjes e moszbatimit të ligjit e Kodit të Transmetimit.

Bazuar në gjetjet e këtij shqyrtimi analitik rezultoi se për *Televizionin Klan*:

- publikoheshin të dhëna vetjake të fëmijëve për interes publik duke respektuar kërkesat ligjore;

- kishte raste të neglizhencës në zbatimin e kërkesave ligjore dhe etike në raportimet për fëmijët;
- promovimi i fëmijëve në spektakle dhe veprimtari ishte në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet etike;
- u evidentuan raste të veçanta të mosrespektimit të të drejtave të fëmijëve në lajmet që nuk u drejtohen atyre (nga kronika “e zezë” në lajme).

Për televizionin *Top Channel*:

- respektoheshin parimet themelore të veprimtarisë audiovizive për fëmijët në edicionet informative;
- zbatoheshin kërkesat ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në lajmet mbi e për fëmijët.
- në një rast nuk u respektua Kodi i Transmetimit e të standardeve etike në lajmet që nuk lidhen drejtpërdrejt me fëmijët;
- përmbusheshin kërkesat ligjore në raportimet nga “kronika e zezë” dhe për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar në edicionet informative.

Për *Televizionin Publik shqiptar, TVSH*:

- respektoheshin kërkesat e ligjit dhe të Kodit të Transmetimit për të drejtat e fëmijëve në programet informative;
- zbatim i kërkesës ligjore për transmetimin e një edicioni informativ me gjuhën e shenjave, për personat me aftësi të kufizuar;
- përsëritje e shpeshtë e kronikave e të njëjtave kronika lajmesh për fëmijët, brenda një dite e në ditët në vijim;
- përfshirje e lajmeve për fëmijët me synime nxitëse dhe sensibilizuese për shoqërinë dhe institucionet përkundrejt fëmijëve;
- mungonte pasqyrimi dhe promovimi në edicionet informative i programeve për fëmijë të prodhuara nga TVSH.

Për televizionin *Vizion Plus*:

- pasqyrim me tepri i gjuhës së dhunës politike në edicionet e lajmeve, pavarësisht se kronikat nuk drejtohen drejtpërdrejt fëmijëve;
- transmetim në përputhje me kërkesat e ligjit, por i pamjaftueshëm, i veprimtarive me dhe për fëmijët.
- respektim i kërkesave ligjore dhe etike në përmbajtjet e lajmeve të “kronikës së zezë”.

Të miturit në hapësirat programore të Transmetuesit Publik - Një tjetër shqyrtim analitik, gjatë muajit qershor 2016, i kushtohet po programeve për fëmijë në Televizionin Shqiptar, TVSH, për të ndjekur zbatimin e kërkesave ligjore dhe të Kodit të Transmetimit në kanalin kryesor të Transmetuesit Publik. Në qendër të shqyrtimit ishte struktura programore, në përbërje të së cilës janë programet informative, social-kulturore, muzikore, argëtuese, filmat artistikë e dokumentarë, programe për fëmijë, filmat vizatimorë dhe artistikë, koncertet për fëmijë, programe sportive, komunikimet tregtare audiovizive etj.

Nga të dhënat dhe gjetjet e shqyrtimit analitik rezultoi se TVSH, përgjithësisht, ndjek dhe zbaton kërkesat ligjore e standardet bashkëkohore për raportet sasiore ndërmjet llojeve e natyrave të ndryshme të programeve, duke synuar të plotësojë në gamë sa më të gjerë e të larmishme kërkesat e teleshikuesve. Në çdo ditë të programacionit të monitoruar, janë planifikuar dhe

transmetuar programe për fëmijë, emisione e filma vizatimorë, të përkthyer në shqip, që zënë një pjesë të programit të përgjithshëm, sipas një strukture pak a shumë të përcaktuar. TVSH-ja është më e konsoliduar si përmbajtje programore për përfaqësimin e moshave të ndryshme, si dhe ka numrin më të lartë të emisioneve të llojeve të ndryshme, kulturore, edukative dhe argëtuese që u drejtohen fëmijëve.

Por u evidentuan dhe problematika, ndër më kryesoret përmendim:

- emisionet me dhe për fëmijë zënë mesatarisht 2 orë transmetim në ditë, përqindje kjo relativisht e vogël në raport me programin ditor;
- ka mungesë të emisioneve për fëmijë në fashën orare 16:00-20:00, që vlerësohet dhe si harku kohor me shikueshmëri më të lartë nga fëmijët, ndërkohë përqendrimi është në periudhën 07:00-14:00, kur fëmijët presupozohet të mos jenë domosdoshmërisht para ekranit;
- janë shumë të rralla përmbajtjet për target-in në grupmoshat 14 vjeç e lart duke mos reflektuar as tiparet dhe specifikat për produkte me interaktivitetit dhe bazuar preferencat që ka kjo gjeneratë për mediat e reja;
- në ditë të caktuara, vërehet ritransmetim i emisioneve ose i rubrikave të transmetuara më parë, në të njëjtin emision;
- TVSH, në programet e monitoruara, respekton kërkesat e standardet etike, por përdor rrallë shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve.

Gjetjet e këtij shqyrtimi ju bënë prezent dhe Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së dhe Këshillit Drejtues përmes dërgimit të një informacioni të zgjeruar.

b) Hapësira promionale në mediat audiovizive

Reklamat dhe komunikimet me natyrë tregtare në tregun audioviziv janë një element shumë i rëndësishëm për operatorët. Kjo për disa arsye se ato janë pjesë e përmbajtjeve që emetohen për audiencën dhe si të tilla kërkojnë energji ideuese, krijuese dhe prodhimi, plus atraktivitet për ndjekësit. Nga ana tjetër një reklamë a komunikim me natyrë tregtare ndikon drejtpërdrejt tek publiku, pasi përmes saj ai informohet dhe orientohet për një shërbim, një mall, një aktivitet etj.

Gjatë vitit 2016 vijoi angazhimi për të realizuar shqyrtime analitike ndaj performancës së OSHMA-ve, duke evidentuar çështjet problematike më shqetësuese. Me gjetjet dhe problematikën janë njohur dhe vetë OSHMA-të, duke ju prezantuar (mos)përputhshmërinë ligjore.

Janë organizuar 2 takime me operatorët e monitoruar, sikundër dhe janë ndërtuar dhe partneritete me institucione e subjekte që janë të angazhuar po në fushën e reklamave dhe komunikimeve me natyrë tregtare në mediat audiovizive, të tilla si Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve; Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë; Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë; Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore etj.

Nga shqyrtimet analitike të realizuara nga AMA një nga defektet në performancën e disa operatorëve është kohëzgjatja e bllokut të reklamave, ku ka pasur raste të tejkalimit dyfish ose më shumë të kohës prej 12 minuta në një orë që lejon ligji. Në nenin 41 pika 1 të ligjit 97/2013

thuhet: “... Kohëzgjatja e reklamave ose shitjeve të drejtpërdrejta nuk duhet të kalojë 12 minuta për një orë transmetim. Këtu nuk përfshihen njoftimet e OSHMA-së, në lidhje me programet e veta dhe produktet ndihmëse për këto programe, njoftimet për sponsorizimin dhe vendosjen e mallrave në programe.”

Reklammat me ekran të ndarë. Nga televizionet e formatit info transmetohen reklama në ekran të ndarë, (reklama në kënd të ekranit) dhe reklama me tekst të lëvizshëm (titra), poshtë ekranit. Neni 38 i ligjit 97/2013, pika 3 (d) përcakton se kohëzgjatja e reklamave në kënd dhe me tekst të lëvizshëm llogaritet në kohën e përgjithshme të transmetimit të reklamave, pra 12 minuta. Kjo kërkesë e ligjit nuk zbatohet, sepse emetimi i reklamave me kënd është thujse nonstop, vetëm kur ekрани hapet i plotë për emetimin e edicioneve kryesore apo formate programesh forum, dokumentarë, speciale të ndryshme etj. Po kështu dhe reklammat me titra në pjesën e poshtme të ekranit janë po pa ndërprerje.

Vendosja e produktit. Në disa emisione, kryesisht me natyrë kulinarie, por dhe programe argëtuese dhe zbavitëse vendosja e produkteve nuk identifikohet. Nuk ka ndarje të qartë mes përmbajtjes së programit dhe komunikimeve tregtare audiovizive, sidomos për teleshitjet dhe vendosjen e produktit. Neni 3, pika 51 i ligjit 97/2013 saktëson se, “Vendosje e produktit’ është çdo formë e komunikimeve me natyrë tregtare audio dhe/ose audiovizive, që përfshijnë ose i drejtohen një malli, shërbimi ose marke tregtare, që shfaqet ose përmendet në një transmetim, përkundëjt pagesës ose përfitimeve të tjera të ngjashme. Kurse neni 44, pika 4 thotë se “programet që përmbajnë vendosjen e produkteve duhet të identifikohen qartë në fillim, gjatë tij ose në përfundim të programit dhe kur programi përfundon pas një pushimi reklamash, në mënyrë që të shmangin çdo çoroditje të shikuesve.” Neni 44, pika 3 (b,c), përcakton se këto lloj komunikimesh tregtare: “nuk duhet të nxisin drejtpërdrejt marrjen ose përdorimin e mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht duke bërë përmendje të posaçme promovionale të këtyre mallrave dhe shërbimeve dhe gjithashtu nuk duhet t’i kushtojnë vëmendje të tepruar mallrave në fjalë”.

Dallimi i reklamave dhe shitjet e drejtpërdrejta. Janë evidentuar shembuj kur nuk bëhet i qartë dallimi mes një përmbajtjeje programi dhe shitjes së drejtpërdrejtë, duke mos respektuar nenin 43, pika 1, sipas të cilit, “Reklama dhe shitjet e drejtpërdrejta duhet të jenë të dallueshme dhe të veçanta nga përmbajtja tjetër që është nën përgjegjësinë editoriale dhe të veçohen nga pjesa tjetër e përmbajtjes së programit edhe kur mund të transmetohen njëkohësisht, nëpërmjet mënyrave pamore dhe/ose zanore dhe/ose ndarjes së hapësirës së tyre në ekran.”

Reklama në edicionet informative. Të ndërtuara si kronika me natyrë ekonomike, shëndetësore, arsimore, kulturore, sociale etj., janë evidentuar përmbajtje audiovizive si komunikim i fshehtë me natyrë tregtare, rrethanë që bie në kundërshtim me nenin 3 të ligjit, “komunikim i fshehtë audioviziv me natyrë tregtare’ është paraqitja me fjalë ose figurë e mallrave, shërbimeve, emërtimit, markës së prodhimit ose i veprimtarive të një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrorjë publikun mbi natyrën e tij...”.

Reklamata virtuale. Shfaqen në ekran me logo, të cilat kategorizohet si reklame virtuale, të cilat transmetohen pa paralajmërim paraprak, pamor apo akustik, për teleshikuesin, duke mos respektuar nenin 38, pika 4, (a) të ligjit “OSHMA-ja duhet të informojë për qenien e reklamave virtuale në transmetim”.

c) Respektimi i kërkesave ligjore për veprat evropiane

Koha që ju rezervojnë televizionet kombëtare veprave evropiane ka qenë në qendër të një shqyrtimi analitik që i krye në muajt tetor dhe nëntor, bazuar në kërkesat e ligjit 97/2013, të shprehura në nenin 35, pika 1, ku përcaktohet se “OSHMA-të u rezervojnë veprave evropiane, shumicën e kohës së tyre të transmetimit, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojërat, reklamata, shërbimet e teletekstit dhe të shitjeve të drejtpërdrejta në televizion”. Fokusi ishte tek televizionet kombëtare nisur po nga kërkesat ligjore, pasi në pikën 3, po të nenit 35 theksohet se veprat evropiane “...nuk zbatohen për transmetimet televizive, të cilat i drejtohen audiencës lokale dhe që nuk janë pjesë e rrjetit kombëtar”.

Shqyrtimi i bazua dhe në përcaktimet e nenit 3 (përkufizime), pika 52, që saktëson se cilat quhen vepra evropiane në transmetimet audiovizive, si dhe kërkesat ligjore për raportet sasiore duke u bazuar në pikën 2, të nenit 35 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se, koha e transmetimit të veprave evropiane, arrihet në mënyrë graduale duke marrë në konsideratë përgjegjësitë informuese, edukuese, kulturore dhe zbavitëse që ka OSHMA-ja ndaj publikut.

Përlllogaritja e kohës totale që zinin veprat evropiane në minuta, orë dhe përqindje në programet e televizioneve kombëtare u bë pasi u përjashtua hapësira kohore që zënë lajmet, reklamata, lojërat, ngjarjet sportive, shërbimet e teletekstit dhe të shitjeve të drejtpërdrejta, duke u përjashtuar nga koha totale e regjistrimeve ashtu siç përcaktohet në nenin 35, pika 1 të ligjit 97/2013.

Nga ky shqyrtim i konstatua se televizionet e respektonin këtë kërkesë ligjore, duke ndikuar me transmetimin e përmbajtjeve të tilla për informimin dhe edukimin e audiencës me vlerat evropianiste, si një aspiratë e shoqërisë shqiptare në rrugën e saj të integritimit për në BE. Monitorimi i këtij aspekti të programeve audiovizive nga subjektet kombëtare do të vijojë të jetë në fokus të AMA-s, për zbatimin e kërkesave të ligjit 97/2013.

5.2 Administrimi dhe publikimi informacionit për sektorin audioviziv

Në vitin 2016 AMA ka startuar publikimin për herë të parë të Buletinit Periodik të AMA-s, një fluks të dhënash nga performanca e OSHMA-ve. Tregu mediatik audioviziv ka një ndikim të jashtëzakonshëm në dinamikën e zhvillimeve të gjithanshme në Shqipëri. Fluksi i transmetimeve audio dhe audiovizive është një infrastrukturë, në radhë të parë në favor të informimit, edukimit dhe zbavitjes së popullatës; një hapësirë punësimi dhe gjenerimi të ardhurash nga produktet dhe shërbimet që ofrohen; një “ring” ku në mënyrë të pashmangshme konkurrohet me stafe dhe ide; ku qarkullojnë dhe aplikohen me shpejtësi marramendëse projekte gazetareske, teknike dhe teknologjike; ku lëvizet pandërprerë për transformim e inovacion, një përpjekje e natyrshme për t’u sinkronizuar me atë që ndodh në tregjet globale mediatike.

Mbledhja, administrimi dhe publikimi i informacionit për sektorin e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, si një nga funksionet kryesore që i atribuohen AMA-s me ligj, ishte një nga shtysat kryesore për fillimin e botimit në mënyrë periodike të këtij Buletini. T'u prezantojë të gjitha grupeve të interesit tregues nga performanca e ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv, OSHMA-ve.

Lënda e Buletinit është e strukturuar në disa shtylla kryesore të dhënat e mbledhura:

- tregues të aktivitetit ekonomik e financiar;
- pronësia në aktivitetin audioviziv dhe lidhja me degë të ndryshme të industrive;
- tipare të personelit të angazhuar në OSHMA-të;
- aspekte teknike dhe të mbulimit me sinjal transmetimi;
- monitorimi i përmbajtjeve të emetuara;
- volumi i reklamave e blerësit më të mëdhenj të kohës promovionale.

Të përmbledhura në rubrika dhe nënrubrika këta tregues janë një fotografi për një periudhë të përcaktuar, si një akses e mundësi dhe për cilindo që dëshiron të bëjë vlerësime sasiore, cilësore e krahasimore, pjesore e tërësore, si një bazë për studime dhe analiza tregu, të asaj që ndodh sot, a asaj që pritet të ndodhë në të ardhmen.

Buletini ka si burim kryesor të gjitha të dhënat që OSHMA-të kanë depozituar zyrtarisht në periudhën e aplikimit të tyre për licencë/rilicencë ose autorizim/riautorizim, mbi aktivitetin e tyre në tregun audioviziv, por dhe të dhëna të tjera pjesore të aktualizuara nga performanca e tyre. Tek aspektet e përmbajtjeve të emetuara, kryesisht në edicionet kryesore të lajmeve, tek volumi i reklamave nga OSHMA-të kombëtare, si dhe për zonat e mbulimit me sinjal transmetimi në të gjithë territorin e vendit, të dhënat janë evidentuar nga monitorimet e sistematike të vetë Autoritetit.

Për pjesën e treguesve ekonomikë dhe socialë janë përdorur të dhëna nga OSHMA-të, deklaratimet periodike që secila prej tyre ka bërë pranë institucioneve publike kombëtare dhe rajonale mbi derdhjen e kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, pasqyrën e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna.

Për aspektet e pronësisë dhe bashkëpronësisë në OSHMA-të, si dhe për kontributet e pronarëve dhe aksionerëve jashtë tregut audioviziv si referencë kanë shërbyer dhe informacionet nga QKR-ja. Për një sërë treguesish janë bërë kryqëzime të të dhënave me ato që posedojnë institucione të tjera publike me të cilat AMA ka marrëdhënie bashkëpunuese, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore etj.

Impakti i ndërtimit të një Buletini Periodik me tregues nga dinamika e tregut audio dhe audioviziv në Republikën e Shqipërisë është i dyanshëm:

- së pari, AMA në çdo moment ka në dispozicion një depozitë të dhënash, që i referohen një periudhe kohore të caktuar, të aksesueshme në çdo moment nga vetë aktorët e tregut, subjektet dhe institucionet e interesuara, nga publiku i gjerë;

- së dyti, qarkullimi i Buletinit do të rrisë standardin e raportimit të treguesve të aktivitetit dhe performancës së OSHMA-ve, element që ndikon në cilësinë dhe vërtetësinë e një botimi të tillë, në print a online.

Aktualisht pejzazhi audioviziv në Shqipëri është në një fazë tranzitore për të konkretizuar një nga operacionet më të rëndësishme: kalimin e transmetimeve televizive nga analogu në digjital tokësor. Kurorëzimi do të shkaktojë dhe ndryshime në performancën e OSHMA-ve, që do të grupohen në platforma numerike, për rrjedhojë do të prodhohen tregues të ndryshëm nga këta që janë pasqyruar në edicionin e parë të Buletinit për periudhën e gjashtëmuajorit të parë të vitit 2016.

Gjithashtu dhe ofrimi i shërbimeve audio dhe audiovizive në formate që kanë në bazë internetin pritet të kapërcejë fazën e tanishme latente dhe spontane, duke u bërë pjesë vitale e tregut në tërësi. Edhe ky është një argument për ndryshim të rikonfigurimit të treguesve në edicionet e ardhshme.

5.3 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave

Në kuadër të planifikimit dhe administrimit të spektrit të frekuencave, si një burim i kufizuar, i cili duhet të shfrytëzohet me efikasitet, AMA ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave dhe ka përditësuar planin e përdorimit të frekuencave për shërbimet audio dhe audiovizive.

AMA ka kryer studime teknike në programin profesional ICS Telecom lidhur me kërkesat e paraqitura nga subjekte audio/audiovizivë për ndryshim të karakteristikave teknike të transmetimit apo ndryshim të zonës së shërbimit. Studimet konsistojnë në kryerjen e llogaritjeve teknike mbi mbulimin e zonës së shërbimit me sinjal si dhe shmangien e interferencave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Administrimi dhe planifikimi i frekuencave audio/audiovizive kryhen në kuadër të licencimit të operatorëve audio/audiovizivë të cilët përdorin frekuncat e brezit audio/audioviziv. Gjatë vitit 2016 janë licencuar 5 rrjetet private kombëtare numerike për ofrimin e shërbimeve audiovizive si dhe 4 subjekte për ofrimin e shërbimit audio të radiove të komunitetit.

Planifikimi i frekuencave për shërbimin audioviziv - AMA ka përcaktuar karakteristikat teknike të transmetimit dhe përgatitur Dokumentacion Teknik për çeljen e garës së licencimit për 5 (pesë) rrjetet private numerike kombëtare, mbi bazën e të cilave u licencuan në prill 3 operatorë privatë kombëtarë numerik dhe në dhjetor 2016-janar 2017, dy operatorët e tjerë privatë kombëtarë numerikë. Rrjetet numerike që i përkasin 5 operatorëve janë si më poshtë:

- Rrjeti MUX3 i është dhënë në përdorim subjektit Klan
- Rrjeti MUX4 i është dhënë në përdorim subjektit Digitalb

- Rrjeti MUX5 i është dhënë në përdorim subjektit Top Channel
- Rrjeti MUX6 i është dhënë në përdorim subjektit Vizion +
- Rrjeti MUX7 i është dhënë në përdorim subjektit ADTN

Përcaktimi i karakteristikave teknike të transmetimit për ndërtimin e rrjeteve numerike tokësore bëhet në përputhje me Aktet Finale të Konferencës Rajonale të Radio komunikacioneve për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06), Gjenevë 15 maj-16 qershor 2006, pa përfshirë brezin e Dividentit Digjital (DD1).

Frekuencat e përcaktuara nga AMA për ndërtimin e rrjeteve numerike kombëtare publik dhe privat janë sipas tabelave të mëposhtme:

Kanalet frekuencorë për 2 rrjetet publike kombëtare numerike të RTSH-së në brezin UHF

Rrjetet Publike	Allot. Shkodër	Allot. Kukës	Allot. Dibër	Allot. Lezhë	Allot. Tiranë	Allot. Elbasan	Allot. Fier	Allot. Berat	Allot. Korçë	Allot. Gjirokastrë	Allot. Vlorë
MUX-1	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
MUX-2	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

Kanalet frekuencore për 5 rrjetet private kombëtare numerike në brezin UHF

Rrjetet private	Allot. Shkodër	Allot. Kukës	Allot. Dibër	Allot. Lezhë	Allot. Tiranë	Allot. Elbasan	Allot. Fier	Allot. Berat	Allot. Korçë	Allot. Gjirokastrë	Allot. Vlorë
Klan MUX-3	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
Digitalb MUX-4	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
Top Channel MUX-5	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
Vizion + MUX-6	22	36	54	-----	57	46	29	24	21	48	-----
ADTN MUX-7	51	52	60	-----	39	40	45	47	27	35	-----

Kanalet frekuencore të mbetura të lira për brezin VHF dhe UHF janë:

	Allot. Shkodër	Allot. Kukës	Allot. Dibër	Allot. Lezhë	Allot Tiranë	Allot. Elbasan	Allot. Fier	Allot. Berat	Allot. Korçë	Allot. Gjirokastrë	Allot. Vlorë	allot. Tirane
Kanalet e lira në VHF	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8	6
Kanalet e lira në UHF		56				56	51	52	28	38		26
						58			59	53		37
										56		44
										58		50
									60			60

Kanalet e lira do të planifikohen nga AMA, në varësi të kërkesave që do të paraqiten në AMA, për licencimin e operatorëve lokalë dhe rajonalë.

Planifikimi i frekuencave për shërbimin audio - AMA me vendimin nr. 55, datë 04.04.2016 ka miratuar rregulloren “Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit.

Neni 58 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikon se AMA përcakton, me anë të një dokumenti rregullator, sasinë e frekuencave në dispozicion të shërbimit të transmetimit audio të komunitetit, si dhe zonën gjeografike të ofrimit të shërbimit, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave.

Bazuar në aktin rregullativ të hartuar/miratuar nga AMA, janë përcaktuar karakteristikat teknike të transmetimit për 4 subjektet audio të cilët paraqitën interes për t’u licencuar për ofrimin e shërbimit audio të radiove të komunitetit.

Në kuadër të procesit të rinovimit të licencave të operatorëve audio në treg, u shfuqizuan licencat e disa operatorëve audio të cilët nuk kishin zbatuar kushtet e licencës, duke krijuar kështu rritje të disponueshmerisë së frekuencave.

Mbi bazën e ndryshimeve të ndodhura është hartuar Plani i Përdorimit të Frekuencave audio, ku identifikohen të gjitha frekuencat e zëna dhe frekuencat e lira për çdo pikë transmetimi.

Në kuadër të shfrytëzimit me efektivitet të spektrit të frekuencave audio, AMA ka planifikuar në buxhetin e vitit 2017, kryerjen e një studimi të thellë teknik, në mënyrë që ky spektër të përdoret në mënyrë sa më efektive si dhe t’i hapet rrugë licencimit të operatorëve të rinj në tregun audio.

Plani kombëtar i Frekuencave - Bazuar në nenin 19 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, AMA bashkëpunon me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

Në këtë kuadër, me Urdhrin nr. 23, datë 21.07.2016 të Kryeministrit, është ngritur grupi i punës për “Përditësimin e Planit Kombëtar të Frekuencave (PKF) si dhe Hartimin e Dokumentit të Politikës Spektrale (2016-2020), grup në të cilin AMA përfaqësohet me tre anëtarë, nisur nga rëndësia e këtyre akteve ligjore.

Lidhur me hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave, me rëndësi në këtë grup punë ishte përcaktimi i institucioneve përkatëse të cilët do të jenë administratorë të brezit të frekuencave 790-862 MHz (brezi DD1) dhe brezit të frekuencave 694-790 MHz (brezi DD2). AMA paraqiti propozimet e veta të cilat u morën parasysh nga grupi i punës dhe janë reflektuar në draftin final, i cili pritet të miratohet së shpejti. Ndërkohë grupi i punës vijon punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Frekuencave.

5.4 Trajtimi i ankesave

Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave - Mbështetur mbi Ligjin Nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 për Mediat dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë, duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë. Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Në një nga seksionet e faqes zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al, është rubrika “Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit” ku në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t’ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në dokumentin i cili quhet Buletini i Këshillit të Ankesave. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk

lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.

Në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive kanë mbërritur ankesa nga institucione shtetërore, organizata joqeveritare dhe individë të ndryshëm. Këshilli i ka vërejtur dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha ankesat, duke i argumentuar përgjigjet e tyre dhe vendimet për to, bazuar mbi nenet dhe rregullat e hartuara në Ligjin për Mediat Audiovizive, Nr. 97/ 2013. Prej tyre, çështjet ankuese më sensitive kanë qenë ato rregulla dhe parime, shkëlja e të cilave përbën cenim të të drejtave të të miturve në transmetimet audiovizive. Kujtojmë se Kodi i Transmetimit, ndër parimet themelore të tij, ka garantimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtën absolute të tij për privatësi.

Nga dhjetra ankesa, disa prej tyre kanë pasur për objekt pikërisht cenimin e të drejtave të të miturve të cilave, Këshilli u është përgjigjur menjëherë duke u sjellë vazhdimisht në kujtesë operatorëve audiovizivë përmbajtjen e rregullave të Kodit të Transmetimit. Çështje të tjera të trajtuara janë ato me objekt shkëljen etike në transmetimet audiovizive, përkatësisht, cenimin e dinjitetit dhe privacisë, tw tjera mbi Të Drejtat e Autorit, të cilat nuk kanë qenë kompetencë e Këshillit të Ankesave dhe, si rrjedhojë, u janë kaluar Drejtorive të tjera në AMA, në rastet konkrete Drejtorisë së Mbikëqyrjes.

Gjithashtu, në Autoritetin e Mediave Audiovizive kanë mbërritur edhe Letra të Hapura me objekt marrjen e masave për zbatimin e Kodit të Transmetimit, të cilat i janë kaluar për shqyrtim Këshillit të Ankesave, si struktura që ka kompetencën të vrojtojë zbatimin e këtyre akteve nënligjore të hartuara nga AMA; si dhe ankesa që nuk janë konsideruar të tilla, bazuar mbi rregullat dhe aktet nënligjore të përfshira në Kodin e Transmetimit.

Vendimet lidhur me këto ankesa janë marrë gjatë mbledhjeve që Këshilli i Ankesave ka kryer në 6-mujorin e dytë të vitit 2016.

6. AUTORITETI NE PERMBUSHJE TE ZBATUESHMERISE LIGJORE

6.1 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve

AMA përgjatë këtij viti ka vijuar punën për plotësimin e kuadrit nënligjor, nëpërmjet hartimit të akteve të reja rregullatore por edhe draftimit të një sërë ndryshimeve në rregulloret ekzistuese. Kështu, AMA ka miratuar aktet e mëposhtme

-Rregullore "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio" (vendimi nr. 153, datë 18.07.2016, ndryshuar me vendimin nr.232, datë 03.11.2016).

Në të parashikohen rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së transmetimit audio, në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Miratimi i këtij akti nënligjor i ka hapur rrugën procesit të licencimit të subjekteve për veprimtari radiofonike private.

-Rregullore “Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit” (vendimi nr. 55, datë 04.04.2016)- Në të parashikohen rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit. Miratimi i këtij akti nënligjor i ka hapur rrugën procesit të dhënies së licencave për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit, shërbim i cili bazuar në aktet ligjore licencohet nëpërmjet zhvillimit të konkurrimit publik. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, AMA me vendimin nr. 55, datë 04.04.2016, miratoi rregulloren për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit. Sipas këtyre akteve, transmetimet komunitare janë transmetime audio për komunitetin të cilat:

- ofrohen për zhvillimin social dhe përmbushjen e interesave të komunitetit;
- reflektojnë nevojat kulturore, gjuhësore,
- ofrojnë programe në përputhje me interesat e komunitetit që i shërbejnë;
- kanë karakter informues, edukativ dhe argëtues;
- mbështeten në punën vullnetare të pjesëmarrësve të komunitetit;
- krijojnë mundësi për të lejuar aksesin më të madh të mundshëm të gjithë pjesëmarrësve të komunitetit; kanë struktura menaxhuese, përfaqësuese të komunitetit të cilit i shërbejnë.

AMA me vendimin nr. 245, datë 21.12.2016 ka përcaktuar frekuencat për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit dhe ka çelur garën për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit. Në vijim, AMA në muajin dhjetor 2016, shpalli në mënyrë publike procedurën për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit për 4 zona ofrimi shërbimi. Pranë AMA-s në datën e përcaktuar, si datë përfundimtare për depozitimin e aplikimeve janë depozituar 3 aplikime, përkatësisht prej “Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë”, “Kryegjyshitës Botërore Bektashiane” dhe Shoqatës “Radio Maria”, aplikime të cilat janë ende në fazën e shqyrtimit administrativ.

-Rregullore “Për transmetimin pa shpërblim të informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve me interes të lartë për publikun e gjerë” (vendimi nr. 76, datë 04.04.2016). - Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i llojit dhe tipologjisë së informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve që konsiderohen se paraqesin interes të lartë për publikun e gjerë, subjektet që emetojnë këtë lloj informacioni si dhe kushtet e transmetimit nga ana e ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe audioviziv.

-Rregullore “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për renditjen e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete numerike” (vendimi nr. 218, datë 12.10.2016, ndryshuar me vendimin nr. 246, datë 21.12.2016). - Në këtë akt parashikohen rregullat, kriteret dhe procedura e caktimit të numrit identifikues për ofruesit e shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv.

-Rregullore “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”, (vendimi nr. 219, datë 12.10.2016). - Miratimi i këtij akti nënligjor i ka hapur rrugën procesit të dhënies së licencave kombëtare të transmetimit audioviziv numerik. AMA në zbatim të kompetencave ligjore me qëllim caktimin e pagesave bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës, jo diskriminimit dhe proporcionalitetit ka miratuar ndryshime në vendimet ekzistuese për caktimin e pagesave për licencë dhe autorizim.

Po ashtu, gjatë periudhës raportuese ka vijuar puna për rishikimin e legjislacionit sekondar, dhe për hartimin e akteve nënligjore të kërkuara prej ligjit organik. Në mënyrë më të detajuar, aktet që janë në proces rishikimi janë:

-Rregullorja “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, akt i cili është miratuar me vendimin e AMA-s nr. 56, datë 10.07.2015. - Gjatë zbatimit të këtij akti rregullator janë hasur një sërë problematikash nga subjektet aplikues lidhur me përgatitjen e dokumentacionit për pajisje me autorizim. Kështu, në aktin nënligjor të sipërcituar, pavarësisht llojit të mënyrës së ofrimit të shërbimit OTT, IPTV apo sistemin internet, kriteret për marrjen e autorizimeve kanë qenë të përbashkëta për të gjithë llojet e autorizimeve, pavarësisht se këto shërbime kanë specifika dalluese. Po ashtu, në aktin nënligjor ekzistues, nuk kanë qenë parashikuar rregullat dhe kriteret për zgjerimin, zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit, apo për rinovimin e autorizimit. Ky projekt akt i është nënshtruar procesit të këshillimit publik. AMA me shkresën nr. 3005 prot., datë 04 tetor 2016, ka kërkuar nga subjektet e licencuar/autorizuar mendim për projekt-aktin e propozuar dhe në përgjigje të shkresës së sipërcituar pranë AMA-s kanë ardhur propozime për projekt rregulloren e mësipërme prej disa subjekteve privatë audiovizivë.

-Rregullorja “Mbi procedurat e inspektimit/monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, akti i cili është miratuar me vendimin e AMA-s nr. 21, datë 27.12.2013. - Në këtë akt janë parashikuar procedurat e inspektimit dhe monitorimit të veprimtarisë së subjekteve ofrues të shërbimit mediatik audioviziv. Për shkak të zhvillimeve të zhvillimeve të reja teknologjike dhe qasjes ndaj subjekteve audio/audiovizivë, duke qenë se ky akt nuk përcakton parimet, të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë veprimtarisë së inspektimit, lindi nevoja e rishikimit të këtij akti nënligjor. Në këtë kuadër, në projekt aktin e ndryshuar përcaktohen më qartë të drejtat dhe detyrimet e AMA-s dhe të subjekteve, në mënyrë të veçantë parimet themelore ku do të bazohet e gjithë veprimtaria inspektuese. Përmes kësaj rregulloreje synohet kryerja sa më transparente dhe me efikasitet e veprimtarisë inspektuese, duke u dhënë subjekteve të inspektuara (OSHMA) më tepër të drejta përkundrejt administratës së AMA-s. Në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, rregullorja është publikuar për mendim edhe në faqen zyrtare të AMA-s, ku dhe është kërkuar mendimi i palëve të interesuara.

Rregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore”. - Nëpërmjet këtij akti, AMA synon të përcaktojë rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës lokale të transmetimit audioviziv në periudhën tranzitore, në zbatim të parashikimeve të nenit 139 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe rregullave

për marrjen e licencës lokale të transmetimit audioviziv nga subjektet analogë vendorë që janë të licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv në zonën që planifikohet për t'u mbuluar nga një rrjet SFN.

Rregullore "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes". - Në këtë akt përcaktohen rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen nga Këshilli i Ankesave në përmbushje të objektit të punës së tij të përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", në drejtim të mbikëqyrjes së zbatimit të kodeve dhe rregulloreve, nga Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv dhe Radio Televizioni Shqiptar dhe shqyrtimit të ankesave të depozituara në AMA. Duke pasur parasysh se ligji organik është tërësisht i përafuar me '*acquis communautaire*', edhe rregullimi i procedurave të shqyrtimit të ankesave është në përputhje me direktivën e BE-së 2010/13/EU "Për shërbimin mediatik me zë dhe figurë". AMA me shkresën nr. 3528 prot., datë 11 nëntor 2016, ka kërkuar nga subjektet e licencuar/autorizuar mendim për projektaktin e propozuar dhe në përgjigje të shkresës së sipërcituar pranë AMA-s kanë ardhur propozime për rregulloren e mësipërme prej disa subjekteve privatë audiovizivë një pjese e te cilave te pasqyruara.

Vendimi "Për miratimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun si dhe mënyrën e transmetimit pa pagesë të tyre nga OSHMA-ja e kualifikuar". - Nëpërmjet këtij vendimi AMA synon të përcaktojë shprehimisht ngjarjet të cilat konsiderohen se kanë rëndësi të madhe për publikun brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të përcaktojë mënyrën e transmetimit pa pagesë të një ngjarjeje me rëndësi të madhe, nëse duhet të transmetohet direkt, i regjistruar apo në të dyja mënyrat dhe në të gjithë ose një pjesë të territorit të vendit. Lista është hartuar në mbështetje të detyrimit të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Duke pasur parasysh se ligji organik është tërësisht i përafuar me "*acquis communautaire*", edhe përcaktimi i ngjarjeve me rëndësi të madhe rezulton të jetë në përputhje me direktivat e BE-së 89/552/EEC "Për televizionin pa kufij" dhe 2010/13/EU "Për shërbimin mediatik me zë dhe figurë".

6.2 Përjasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përmbushje të kompetencave të veta sipas ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke garantuar konkurrencën e ndershme në fushën e mediave elektronike. Me qëllim organizimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit audioviziv AMA me ndryshimet e strukturës organizative krijoi edhe Drejtorinë e Mbikëqyrjes, e cila filloi nga puna me kapacitet të plotë në muajin Maj 2016.

Nder funksionet kryesore Drejtoria e Mbikëqyrjes përfshin

- Mbikëqyrjen e veprimtarisë audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet ligjore në fuqi, duke garantuar konkurrencën e ndershme në tregun mediatik;
- Trajtimin e problematikave që ndeshen në fushën e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit në veprimtarinë audio dhe/ose audiovizive në drejtim të parandalimit dhe minimizimit të fenomenit të mosrespektimit të të drejtave të transmetimit/autorit;
- Monitorimi i brezit të frekuencave, identifikimi i shkaqeve dhe shmangia e interferencave të dëmshme që shkaktohen nga dhe në brezin e frekuencave që administrohen nga AMA;
- Krijimin dhe ruajtjen e database-s/arkivit përmes regjistrimeve dhe monitorimeve të përmbajtjeve të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe audioviziv.
- Krijimin, ruajtja dhe azhurnimi i regjistrit:
 - (i) të dokumentacionit të depozituar në AMA nga subjektet OSHMA për sa i përket kalimit të të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit;
 - (ii) të ankesave për të drejtat e transmetimit;
 - (iii) të drejtave të autorit;
 - (iv) të inspektimeve dhe procedimeve administrative të filluara ndaj subjekteve OSHMA për mosrespektimin e parashikimeve ligjore.

Gjatë periudhës raportuese në AMA janë depozituar një sërë ankesash për mosrespektimin e të drejtave të transmetimit/autorit nga subjekte të licencuar/autorizuar ose jo, si dhe nga subjekte të tjerë të interesuar.

AMA ka ndjekur me prioritet të gjitha ankesat të depozituara pranë autoritetit, duke kryer inspektimet në terren apo monitorimet rast pas rasti. Në përfundim të procedurave administrative, AMA ka vendosur sipas rastit, tërheqjen e vëmendjes ndaj subjekteve ose dënimin e tyre me gjobë dhe, në rastet kur subjektet kanë rezultuar se kanë ushtruar aktivitet audioviziv pa autorizimin e AMA-s, ndaj tyre është bërë edhe sekuestrimi i pajisjeve transmetuese audiovizive.

Spektori i Inspektimeve i Drejtorisë së Mbikëqyrjes ka ndjekur me prioritet të gjitha ankesat për pirateri të depozituara pranë autoritetit, duke kryer inspektimet në terren apo monitorimet rast pas rasti. Në përfundim të procedurave përkatëse administrative, janë sanksionuar me gjobë subjektet, për mos respektimin e të drejtave të transmetimit si dhe ndalimin e hyrjes së inspektorëve në mjediset ku janë vendosur pajisjet audiovizive të të licencuarit dhe/ose të të autorizuarit ose nuk jepen të dhënat e kërkuara prej tyre.

Gjithsej gjatë vitit 2016 janë kryer 257 inspektime, nga të cilat janë marre masat e mëposhtme. Në përfundim të shqyrtimit të tyre, janë vendosur 58 vendime për dënim me gjobë, prej të cilave 32 janë shfuqizuar nga Këshilli i Ama-s.

Gjithashtu, për sa i përket subjekteve të pa licencuar/paautorizuar, gjatë vitit 2016, AMA ka ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme një numër të konsiderueshëm aksionesh për ndalimin e gjendjes së informalitetit në të cilin disa subjekte ushtronin aktivitet audioviziv.

Në këtë kuadër, AMA, në total për periudhën raportuese ka bërë ndalimin dhe sekuestrimin e pajisjeve audiovizive të 23 subjekteve audiovizive (kabllorë dhe iptv) të cilët ushtronin veprimtari audiovizive pa autorizim, apo licencë nga AMA. Asnjë prej këtyre vendimeve nuk është kundërshtuar në gjykatë. Pajisjet e sekuestruara janë trajtuar sipas akteve ligjore në fuqi, duke u dorëzuar pranë Arkivit të Shtetit.

Si pasojë gjatë vitit 2016 mes subjekteve audiovizive është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit lidhur me detyrimet që ata kanë në respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit, ndërgjegjësim i cili pasqyrohet në dokumentacionin e depozituar prej OSHMA-ve për kalimin e të drejtave të transmetimit të programeve, si dhe dokumentacionin përkatës për përmbushjen e detyrimeve kundrejt agjencive të licencuara të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.

Ashtu si edhe gjatë vitit të kaluar, edhe përgjatë vitit 2016, një vëmendje e veçantë i është kushtuar garantimit të transparencës së vazhdueshme të veprimtarisë së AMA-s si dhe komunikimit dhe bashkëpunimit të pandërprerë me të gjithë subjektet e përfshirë në fushën e medias dhe të të drejtave të transmetimit/autorit. Në këtë kuptim AMA gjatë periudhës raportuese, nuk ka patur prioritet të vendosë sanksione në mënyrë represive, por të sigurojë komunikim të vazhdueshëm me OSHMA-të, sa i përket mbrojtjes dhe respektimit të së drejtës së transmetimit dhe të drejtës së autorit.

Theksohet se nga monitorimet e programeve të transmetuara është vënë re një zvogëlim i ndjeshëm i fenomenit të transmetimit të programeve pa pasur më parë të drejtat e autorit. Në mënyrë të veçantë, transmetimi i veprave kinematografike nga transmetuesit lokalë, është kufizuar në transmetimin e veprave të prodhuara në Shqipëri dhe nga autorë shqiptarë, duke qenë se edhe sigurimi i të drejtave të transmetimit dhe atyre të autorit për këto vepra është dhe mbetet më e thjeshtë, në krahasim me të drejtat e veprave ndërkombëtare.

Mbetet shqetësim një dukuri e fund vitit dhe sjellja e disa subjekteve, privatë dhe juridike, të cilët operojnë në tregun shqiptar, duke pretenduar se zotërojnë të drejtat e autorit të veprave kinematografike, apo të drejtave të transmetimit për programe (kanale) televizive. AMA ka filluar punën për identifikimin e saktë të këtyre të drejtave. Qëllimi kryesor është të ndihmojë operatorët audio dhe audiovizive të licencuar, apo autorizuar prej saj, që të identifikojnë më saktësi se cili subjekt ka, efektivisht, të drejtat e autorit dhe ato të transmetimit. Puna e nisur në fund të vitit raportues është duke vijuar edhe në vitin në vazhdim.

6.3 Monitorimit i përmbajtjeve

Gjithashtu, përmes Sektorit të Monitorimit dhe Arkivit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, është bërë regjistrimi dhe monitorimi i programacionit të subjekteve audio dhe audiovizivë që transmetojnë në qytetin e Tiranës si edhe disa subjekte audiovizivë lokale, që mbështeten në platformat e ndryshme.

Për subjektet që nuk mund të monitorohen dot përmes Studios së Monitorimit dhe Arkivit, AMA ka kërkuar regjistrimin e programeve të emetuara (transmetuara) në periudha të ndryshme kohore. Kërkesat janë bërë në përputhje me nenin 37 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

Theksohet se, për regjistrimin e subjekteve, në Studion e Monitorimit, janë në funksion 14 kompjuter regjistruar, që sipas një plani mujor (i cili mund të ndryshojë sipas kërkesave të sektorëve dhe problematikave që dalin) regjistrojnë nga ora 07⁰⁰ deri në 04⁰⁰ të ditës së nesërme, për t’u ristartuar përsëri në 07⁰⁰.

Një pjesë ë këtyre kompjuterëve përdoren për monitorimin e platformave: Digitalb Satelitor, Tring Satelitor, Tring Tokësor, IPTV Albtelekom dhe Abcom sipas kërkesave nga drejtoritë e tjera apo anekesave. Në njërin prej kompjuterëve vendosen në regjistrim 2 radiot kombëtare Radio Tirana dhe Top Albania Radio. Po i njejt kompjuter përdoret edhe në rastet kur kryhen regjistrime të radiove vendore për monitorim për të drejtat e autorit.

Në terma statistikorë, në total gjatë këtij viti, janë regjistruar rreth 70,000 orë transmetime audiovizive dhe rreth 5,000 orë transmetime audio.

- Fushat e monitorimit në Studion e Monitorimit janë :
- Reklammat,
- Edicionet informative,
- Detyrimet programore,
- Shqyrtimi i anekesave nga publiku,
- Shqyrtimi i anekesave nga operatorët,
- Monitorimet për të drejtat e transmetimit,
- Monitorimet për të drejtat e autorit.
- Në terma statistikorë do të përmbledheshin në:
- Monitorimi i reklamave të transmetuara nga subjektet audiovizivë kombëtarë, në total rreth 14 000 orë programe të monitoruara,
- Janë monitoruar rreth 1500 edicione informative (900 edicione të subjektet audiovizivë kombëtarë dhe 600 edicione të subjekteve audio kombëtare)

- Regjistrime subjekte audio për përmbushje të detyrimeve programore rreth 300 orë regjistrime.
- Monitorimi i reklamave institucionale për 11 (njëmbëdhjetë) televizione lokale për periudhën janar - dhjetor 2015 rreth 50 000 orë regjistrime.
- Monitorimi i programacionit për të drejtat e transmetimit për subjekte lokale 3300 orë transmetim.
- Monitorimi i programacionit për të drejta transmetimi për 1250 orë transmetim.
- Monitorimi i programacionit për të drejta transmetimi për kanale muzikore 400 orë transmetimi.

Vetëm prej muajit maj 2016, kur ka filluar të funksionojë me kapacitet të plotë Drejtoria e Mbikëqyrjes, në Studion e Monitorimit janë kryer:

- **120** monitorime të subjekteve Ofrues të Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA), si dhe janë kërkuar 41 regjistrim programesh nga subjektet OSHMA të cilët nuk mund të monitorohen dot nga Studio e Monitorimit.
- Prej këtyre regjistrimeve dhe kërkesave për regjistrim janë iniciuar **67** Hetime Administrative në përfundim të të cilave janë vendosur:
- **16** tërheqje vëmendje dhe **7** vënie në dijeni.
- **27** vendime për gjobë, prej të cilave **16** janë shfuqizuar nga Këshilli i AMA-s, pas ankimit administrativ të subjekteve përkatës.

Gjatë vitit 2016, ka përfunduar puna për krijimin e arkivës së institucionit. Të gjitha regjistrimet ekzistuese dhe ato aktuale janë të ruajtura si në format HDD të jashtme ashtu edhe në kaseta LTO. Secili prej sektorëve të drejtorisë ka database-n e vet të të dhënave, për hetimet administrative, për regjistrimet dhe çdo hap dhe masë të ndërmarrë në vijim të procedurave administrative.

6.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Në lidhje me monitorimin e brezit të frekuencave, identifikimin e shkaqeve dhe shmangien e interferencave të dëmshme që shkaktohen nga dhe në brezin e frekuencave që administrohen nga AMA gjatë vitit 2016 është kryer monitorimi në të gjithë pikat transmetuese të vendit. Ky monitorim ka konsistuar në kontrollin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave në brezin 174 - 230 Mhz dhe 470 – 862 për shërbimet audiovizive dhe 88 – 108 MHz për shërbimet audio. Duke konsideruar statusin aktual të procesit të digjitalizimit, operatorët ekzistues privatë kombëtarë analogë janë duke investuar në ndërtimin e rrjeteve numerike duke mos kryer

investime në rrjetet analoge përkatese. Si rrjedhojë, përqindja e mbulimit me sinjal analog mbetet e pandryshuar me atë të vitetve të mëparshme të raportuara.

Nga monitorimi është verifikuar :

- Nëse subjektet e licencuara janë në transmetim
- Subjektet që u është hequr licenca janë në transmetim apo jo
- Subjekte që transmetojnë në mënyrë të paligjshme
- Subjekte që kanë pasur ndërprerje transmetimi më tepër se 30 dite
- Zgjerim i zonës së licencimit
- Mos mbulim me sinjal të zonës së licencimit

Bazuar në monitorimet e kryera shkeljet e konstatuara kanë qenë si më poshtë:

- Subjekte që nuk mbulojnë me shërbim zonën për të cilën janë licencuar. Këta subjekte janë njoftuar zyrtarisht për marrjen e masave të menjëhershme për realizimin e mbulimit sipas licencës;
- Subjekte të cilët transmetojnë jashtë zonës së licencimit (kanë zgjeruar zonën e licencimit pa miratimin e AMA-s). Lidhur me subjektet audio (radio FM) janë njoftuar zyrtarisht këta subjekte për mbylljen e transmetimeve brenda afateve të përcaktuara nga AMA shkelja e të cilave do pasonte vendosjen e sanksioneve.
- Subjekte audio që kanë pasur ndërprerje transmetimi më tepër se 30 ditë.
- Subjekte audiovizive që transmetojnë në mënyrë numerike pa autorizim. Në lidhje me këto subjekte, në rastet kur frekuencat e zëna nga këto subjekte kanë qenë pjesë e planit numerik, këtyre subjekteve u është dërguar shkresë për mbylljen e transmetimeve në mënyrë të menjëhershme.

6.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara në vendet fqinje

Krahas monitorimit të spektrit, vëmendje të veçantë gjatë vitit 2016 i është kushtuar edhe trajtimit të ankesave për interference përcjellë në AMA nga vendet fqinje. Konkretisht:

- Janë trajtuar ankesat për interferencë nga vendet fqinje si Greqia lidhur me shqetësimet në brezin e navigacionit ajror nga subjektet audio tona.
- Ankesat për interferencë janë paraqitur nga Mali i Zi dhe Italia dhe kanë lidhje me transmetimet (numerike & analoge) në brezin e frekuencave DD 1 (790 -862 Mhz).

Gjatë vitit 2016, AMA i ka trajtuar me prioritet duke monitoruar përdorimin e brezit DD1 dhe në bashkëpunim me administratat e vendeve fqinje janë identifikuar burimet e interferencës si dhe janë marrë masa konkrete për eliminimin e tyre. Konkretisht, në pikën transmetuese Tarabosh, janë mbyllur të gjitha transmetimet numerike pa autorizim si dhe subjektet analoge të licencuara në brez DD1, kanë migruar në frekuencë të tjera që nuk i përkasin këtij brezi.

Interferencat e shkaktuara në vendet fqinjë lidhen me përdorimin e brezit 790-862 MHz (DD1) nga operatorët audiovizivë në vendin tonë. Brezi DD1 përdoret gjerësisht nga vendet fqinjë për shërbimet e lëvizshme dhe për këtë arsye operatorët tanë audiovizivë interferojnë në këto rrjete.

Shqetësuese për AMA-n kanë qenë ankesat e përsëritura të ardhura nga Mali i Zi, të cilat janë trajtuar me prioritet nga AMA, duke u përpjekur për t'i dhënë zgjidhjet e duhura. Në korrespondencat e vazhdueshme me rregullatorin e Malit të Zi, është vënë për dijeni edhe MIAP, në kuadër të nxitjes për përshtetimin e procesit të digjitalizimit i cili do të çonte edhe në lirimin e brezit DD1.

Aktualisht, është bërë e mundur shmangia e interferencës së shkaktuar në Malin e Zi nga operatorët audiovizivë që transmetojnë në Shkodër, pasi janë liruar kanalet e brezit DD1 që kanë pasur në përdorim këta operatorë.

7. AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV

7.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv

AMA tashmë vazhdon të ketë një bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e rajonit dhe më gjerë. AMA në këtë proces është duke u investuar për të nxitur frymën e partneritetit me institucione e organizata brenda dhe jashtë vendit të cilat operojnë në fushën e tregut audioviziv. Këto shkëmbime kanë ndikuar që rregulloret apo aktet nënligjore të hartuara dhe të nxjerra nga AMA të kenë edhe konsulencë nga Autoritete të rajonit dhe më gjerë.

Në Seminarin Rajonal për Evropën dhe CIS mbi menaxhimin e spektrit dhe tranzitimn në transmetimet tokësore digjitale në muajin mars dhe ishte organizuar nga ITU në bashkëpunim me Ministrinë e Komunikimeve dhe Shoqërisë së Informacionit dhe Autoritetin Kombëtar për Menaxhimin dhe Rregullimin e Komunikimeve (ANCOM) të Rumanisë ndër çështjet më të rëndësishme që u trajtuan dhe u diskutuan ishin:

- Procesi i kalimit në transmetimet tokësore digjitale;
- Kuadri ligjor dhe rregullator mbi procesin e kalimit në transmetime numerike;
- Aktivitetet e zhvilluara gjatë dhe pas procesit të kalimit në transmetime numerike;
- Shfrytëzimi i dividendit digjital;
- Strukturat e menaxhimit të spektrit dhe mjetet elektronike të përdorura (tools);
- Aktivitetet e zhvilluara pas përfundimeve të dala nga Konferenca Botërore WRC-15.

AMA dhe KPM organizuan takimin konsultativ për aktet nënligjore rregullatorë për ofrimin e shërbimeve mediatike në rrjete kabllorë dhe internet me qëllim shkëmbimin e eksperiencave

mes dy autoriteteve. Fokus ishte edhe konsultimi për aktet nënligjore rregullatorë për ofrimin e shërbimeve mediatike në rrjete kabllore dhe internet. Temat kryesore që u diskutuan ishin ajo e harmonizimit të legjislacionit sekondar për operatorët e autorizuar për ripërtëritjen e programeve audio/audiovizive, përcaktimi i zonës së mbulimit, mënyrat e tarifimit të tyre etj.

Më datë 20 Maj, Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike në kuadër të Javës së Inovacionit organizuan konferencën “Media e gjeneratës tjetër”. Në aktivitet u prezantuan risitë e fundit nga bota teknologjike dhe inovacionit të aplikuara në Shqipëri në infrastruktura të ndryshme të transmetimit numerik si ato tokësore, satelitore, CaTv, IPTV, etj. Në këtë etapë të re të digjitalizimit që po hyn Shqipëria mediat pritet të kenë rolin e tyre më me përkushtim sa i përket garantimit të parimeve bazë të demokracisë dhe në promovimin e lirisë së shprehjes, pluralizmit, diversitetit etnik dhe kulturor si dhe pavarësinë në politikat editoriale të saj.

Operatorët kryesorë në fushën e transmetimeve audiovizive paraqitën një panoramë të investimeve të kryera gjatë viteve të fundit në teknologjinë audio dhe audiovizive në vend. Kjo, si në infrastrukturën transmetuese ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve programore. Gjatë këtyre prezantimeve u trajtuan dhe argumente të cilat lidhen me sfidat dhe angazhimet me të cilat përballet tregu audioviziv në kuadër të zhvillimeve të reja në teknologjinë e transmetimeve audiovizive dhe të telekomunikacionit. Në konferencë ishin të ftuar, gazetarë, subjekte audiovizive, organizatat ndërkombëtare, studiues të medias, shoqëri të telekomunikacionit si dhe gjithë grupet e interesit mbi median dhe teknologjinë.

7.2 Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv

AMA, në përmbushje të detyrimeve ligjore si institucion rregullator bashkëpunon me grupet e interesit, subjektet audio dhe audiovizive që ushtrojnë aktivitetin në të gjithë territorin e vendit. Synimi është që veprimtaria audiovizive të jetë e lirë, që publiku të ketë cilësi dhe shumëllojshmëri në produktet dhe shërbimet që ofron tregu. Qasja e AMA-s në këto dy vitet e fundit ka qenë drejt partneritetit me subjektet televizive, rrjetet numerike, radiot dhe kabllorët duke ndërtuar një komunikim të drejtpërdrejtë dhe transparent në ndërgjegjësimin për domosdoshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore të miratuara, në veçanti Kodit të Transmetimit të AMA-s. Ka rezultate konkrete në përmirësimin e detyrimeve financiare, në respektimin e kushteve të licencimit për zonat e mbulimit, të reduktimit drastik të piraterisë nga kabllorët etj.

Raportimi i çështjeve të fëmijëve në median audiovizive lokale - Nëse projekti i Institutit Shqiptar të Medias, ISHM “Përmirësimi i raportimit të çështjeve të fëmijëve në median audiovizive lokale” gjatë vitit 2015 u realizua vetëm me redaksitë e OSHMA-ve në Tiranë, gjatë vitit 2016 përfitues ishin reporterë dhe redaktorë të mediave audiovizive në qarqet e Korçës, Shkodrës, Gjirokastrës, Vlorës dhe Elbasanit.

Ciklet trajnuese dy ditore për secilin modul, veç qasjes gjithëpërfshirëse, krijojnë mundësi informimi pjesëmarrësit me kuadrin ligjor dhe rregullator për transmetimet audiovizive, Kodin e Transmetimit të AMA-s, përfshirë dispozitat kushtetuese dhe konventat për të drejtat e fëmijëve

si dhe për aspekte profesionale të raportimit, duke prekur tema si aspekte dhe teknika të raportimit të fëmijëve në media, sidomos burimet dhe teknikat e intervistimit.

Seancat e kurseve ishin konceptuar në mënyrë interaktive, ku i është lënë hapësirë nga trajnerët dhe përdorimit të mediave sociale dhe njohja me problematikat e këtij mediumi të ri. Problemet etike që vërehen ishte thelbi i diskutimit, por vëmendje iu kushtua edhe përdorimit sa më efikas të tyre për të paraqitur e shtjelluar tema që lidhen me fëmijët, duke promovuar edhe shembujt pozitivë që nuk mungojnë.

Ngritja e cilësisë në shkrimin dhe transmetimin e lajmeve - Bashkëpunimi i AMA-s me Qendrën “Media Aktive” ishte për realizimin e një praktike intensive në gazetarinë radiotelevizive, si një hapësirë dedikuar trajnimit dhe familjarizimit të reporterëve të rinj me mjaft nga konceptet dhe angazhimet në kushtet reale të punës, si mundësi që të ushtrohen, të ideojnë e veprojnë më shumë me aplikacionet e reja teknologjike dhe internetin. Njëkohësisht ata synuan ngritjen e cilësisë së produktit të tyre në shkrimin dhe transmetimin e lajmeve, në respekt të lirive dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të të miturve, por dhe barazinë gjinore, shmangien e diskriminimit të çdo forme, respektimin e grupeve minore etj., në zbatim të ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit.

Kalendari i aktiviteteve në kuadër të projektit ishte me 30 të tilla, ku u përfshinë rreth 40 pjesëmarrës dhe i dizajnuar në dy faza kryesore:

- e para, përfituesit u fokusuan në tematika nga radio, televizioni, regjia televizive dhe montazhi;
- në të dytën, angazhimi në grupe punuese për veprim dhe produkt konkret, si në kushtet e punës në redaksi - konceptimin e programeve radiofonike, programeve televizive dhe reportazheve.

Produkti i pjesëmarrësve me tema sociale, mbi diskriminimin në baza racore apo orientim seksual, papunësinë, transportin publik, mjedisin, dhuna në familje, dhuna drejtuar gruas, pabarazia gjinore, varfëria etj., u vunë në dispozicion të publikut përmes faqes www.archive.org.

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në Shqipëri - Konferenca e II-të Kombëtare, organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, UNICEF dhe CRCA Shqipëri, në bashkëpunim me organizatat Terre des Hommes, World Vision, Save the Children, Partnerë për Fëmijët, ALO 116, QSHPLI, TLAS, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, Arsis, Fëmijët Sot, Shkej dhe në partneritet me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, dhe Fakultetin e Shkencave Sociale. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori pjesë me prezantimin: *“Mbi funksionimin e mekanizmave ligjore, monitorues dhe institucionale, për të garantuar një paraqitje konform rregullave dhe normave etike të programeve në transmetimet audiovizive”*.

Autoriteti i Mediave Audiovizive mori pjesë në muajin tetor 2016 në mbledhjen e 44-të të EPRA-s në Jerevan. Në takim merrnin pjesë 126 përfaqësues nga 42 autoritete rregullatorë nga 40 shtete ku ekspertët e medias dhanë kontributin e tyre në lidhje me çështjet në fokus të diskutimit: Mediat në kohën e krizës dhe roli i Autoriteteve Rregullatorë, Rastet studimorë në politikat editoriale kundrejt Përmbajtjes së reklamave, Platformat audiovizive. Po ashtu

Autoriteti i Mediave Audiovizive mori pjesë në mbledhjen tjetër të rradhes ku ishin të pranishëm 175 përfaqësues nga 50 vende të botës ku qëllimi kryesor ishte sigurimi i instrumenteve të duhur për autoritetet rregullatore për të kuptuar sa më mirë kompleksitetin dhe konvergjenat që lindin në fushën e mediave. Ekspertë të ndryshëm u fokusuan në ndërlikimet shoqërore, ekonomike dhe teknike që procesi i rialokimit të spektrit të frekuencave po shkakton për audiencën dhe për ofruesit e shërbimit. Temë tjetër e takimit ishte dhe shkëmbimi i eksperiencave dhe praktikave më të mira lidhur me shqetësimet e qeverisjes së brendshme, funksionimit dhe punës së përditshme të autoriteteve rregullatore.

Në korrik 2016 u zhvillua në Madrid takimi i Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore – MNRA, ku takimi kishte në qendër të diskutimeve përmbajtjet audiovizive. Objekt i debatit në dy seancat e para të takimit ishin prezantimet mbi aspektet sportive në televizion dhe ruajtja e balancës gjinore. Në lidhje me këto tematika u prezantuan edhe studime mbi stereotipat seksiste në komunikimet tregtare dhe reklamat.

Po gjate muajit Korrik 2016 – Këshilli i Europës, në kuadër të Projektit *“Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe (JUFREX)”* organizoi një konferencë rajonale për trupat rregullatore të medias në rajon me teme: Standartet europiane dhe praktikat më të mira mbi gjuhën e urrejtjes dhe mbrojtjen e fëmijëve; në Mal të Zi ku dhe Këshilli i Ankesave u paraqit me materialin e vet kërkimor me temë: *“Hate speech në Shqipëri, origjina dhe tipet e gjuhës së urrejtjes”*.

Ne Shtator 2016 - Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Instrumentin e Asistencën Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX) organizoi seminarin mbi *“Median dhe Përputhshmërinë me Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave”*, me pjesëmarrjen e shumë ekspertëve të mirënjohur ndërkombëtarë dhe Këshilli i Ankesave u paraqit me kërkimin e tij me titull: *“Mbrojtja e të dhënave personale tek fëmijët dhe përgjegjësitë e mediave”*.

Ne Nëntor 2016 u zhvillua takimi mes ekspertëve të medias në fushën e Edukimit të Medias në Bruksel: *Media Literacy Expert Group*. Rreth 90 pjesëmarrës nga 28 vende anëtare, 4 vende kandidatë, UNESCO, Këshilli i Europës dhe të tjerë prej shoqërisë civile dhe prej organizatash të medias profesioniste nga 20 vende europiane morën pjesë dhe shkëmbyen mendime lidhur me strategjitë e reja të komunikimit mbi Edukimin për Median.

Ne Shkurt 2017, në takimin Konsultativ kombëtar për Politikën dhe Strategjitë mbi Edukimin për Median dhe Informacionin (EMI) në Shqipëri me Institutin Shqiptar të Medias, Ministrinë së Inovacionit, Ministrinë së Arsimit dhe Autoritetin të Mediave Audiovizive. Këshilli i Ankesave u prezantua me temën: *Praktikat, strategjitë dhe legjislacioni i lidhur me edukimin për median dhe informacionin. Roli i ndërmjetësve të informacionit, i organeve rregullatore dhe i mekanizmave për të ndërgjegjësuar publikun për median dhe informacionin.*

7.3 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore

Autoriteti ka ndërtuar partneritet dhe jashtë tregut audioviziv. Për mjaft aspekte që kanë të bëjnë sidomos me emetimin e përmbajtjeve nga OSHMA-të Autoriteti ka ngritur ura bashkëpunimi me institucione dhe organizata të profilizuara duke krijuar sinergji në dy shtylla kryesore të dinamikës së tregut audioviziv:

- së pari, duke realizuar studime dhe kërkime tregu në qëmtimin e trendeve të transmetimeve audiovizive, si premisë për politika dhe strategji afatgjata në procesin rregullator;
- së dyti, duke punuar me komunitetin e gazetarëve, redaktorëve dhe reporterëve në terren për të përmirësuar performancën në mbulimin e ngjarjeve dhe temave nga aktualiteti dhe perspektiva.

Ky partneritet kushtëzohet dhe nga kërkesat e ligjit 97/2013 "Per mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet mes të tjerave se AMA "realizon, organizon, mbështet dhe promovon kërkimin, në lidhje me çështjet e mediave audiovizive" apo "bashkëpunon me organet e tjera, përfshirë organet përfaqësuese brenda sektorit të mediave audiovizive, për të ndihmuar veprimtaritë trajnuese në sektorin e mediave audiovizive". Ligji saktëson se Autoriteti "ndërmerr, nxit dhe kujdeset për kërkimin dhe veprimtaritë përkatëse, që kanë të bëjnë me rolin e medias, duke përfshirë bashkëpunimin me transmetuesit dhe subjektet e tjera të fushës".

Konkretisht gjatë vitit 2016 AMA ka realizuar projekte bashkëpunuese me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, Departamentin e Shkencave të Komunikimit në Shkollën e Lartë "Hëna e Plotë"- Bedër, me Institutin Shqiptar të Medias dhe Qendrën Media Aktive.

Studimi: "Televizioni dhe televizori-dinamika e një 'divorci' gradual"

Pas organizimit të Konferencës Ndërkombëtare mbi digjitalizimin në nëntor të vitit 2015, AMA bashkëpunoi sërisht me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës për realizimin e një projekti rreth 6 mujor që kishte në fokus kryesor studimin kërkimor: "Televizioni dhe televizori-dinamika e një 'divorci' gradual".

Përmes zhvillimit të një studimi në terren, analizave të gjetjeve dhe publikimi i tyre, u synua dalja në pah e mekanizmave, faktorëve dhe sfidave të inovacionit të teknologjive të industrisë së mediave audiovizive në Shqipëri. Këta tregues thelbësorë u vështruan të bashkërenduar dhe me ndikimin e tyre mbi sjelljen e aktorëve, ofertave përmbajtësore dhe peizazhin mediatik shqiptar.

Kjo përpjekje serioze e monitorimit dhe analizës së dinamikës së tregut audioviziv në vendin tonë nga trupa e profesoriatit dhe me angazhimin e studentëve ishte një produkt cilësor dhe i standardizuar që i nevojitej vetëm AMA-s për të vlerësuar realisht atë që ndodh aktualisht në treg, si dhe trendet dhe dukuritë e të ardhmes, por ishte i dobishëm dhe për:

- vetë grupet e interesit, OSHMA-ve që janë aktualisht në treg, për të gjykuar pozicionin që secila prej tyre zë në treg, por dhe mbijetesën në konkurrencën me të tjerët, zbatueshmërinë e kuadrit legjislativ etj;

- industrinë mediatike (përfshirë atë audiovizive) si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të një vendi, ndaj tregues të dinamikës së saj janë të dobishëm edhe për fokuse jashtë mediatike, kur realizohen peizazhe ekonomike e financiare, data statistikore, vlerësohen parametrat e funksionimit të ekonomisë së tregut a demokracisë, të plotësimit të kërkesave për integrimin evropian të Shqipërisë etj;
- kastën e studiuesve dhe kërkuesve të kësaj fushe, si një lëndë e parë për prezantimin e temave shkencore dhe debatin rreth tyre;
- të gjithë ata që janë të interesuar mbi zhvillimet e medias në përgjithësi dhe atyre audiovizive në veçanti, pasi ky studim përveç se u diskutua në një forum të zgjeruar në Fakultetin e Histori-Filologjisë, por dhe është publikuar si një botim i posaçëm që gjendet në qarkullim.

Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online

Me Departamentin e Shkencave të Komunikimit në Shkollën e lartë “Hëna e Plotë”-Bedër u bashkëpunua për një tjetër projekt kërkimor shkencor që lidhej me performancën e tregut audioviziv, por e vështruar nga një kënd tjetër: mbi sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre.

Një ndër produktet kryesore ishte kryerja e një sondazhi që përfshinte OSHMA-të në Durrës, Korçë, Pogradec, Elbasan, Shkodër, Mamurras Laç, Gjirokastrë Sarandë, Vlorë dhe Tiranë, ku në plotësimin e pyetësorit u përfshinë mbi 200 gazetarë dhe rreth 40 drejtues të subjekteve audio dhe audiovizive lokalë dhe rajonalë. Të dhënat me përgjigjet e pyetësorëve u përpunuan dhe database e krijuar ju shpërnda fillimisht të gjithë studiuesve dhe kërkuesve që ishin pjesë e Konferencës Shkencore mbi këto çështje që u organizua në Tiranë në mes të muajit dhjetor 2016, ku morën pjesë 28 studiues dhe kërkues të fushës së medias audiovizive nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

Veç AMA-s konferenca kishte dhe dy partnerë të tjerë Departamentin e Gazetarisë dhe të Komunikimit në Fakultetin e Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës, si dhe Kolegjin AAB në Prishtinë. Prezenca e studiuesve nga të tre vendet ishte një zgjerim i fushëpunimit mbi sfidat dhe problemet që has tregu audioviziv lokal në kushtet e zhvillimit të internetit dhe mediave të reja. Studimi mbi sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre dhe kumtesat e konferencës u përmbledhën në një botim të veçantë që ju është shpërndarë OSHMA-ve, qendrave kërkimore, departamenteve të gazetarisë në universitete dhe gjithë të intersuarve.

“Standardet evropiane dhe praktikat më të mira për gjuhën e urrëjtjes dhe mbrojtjen e minorenëve” konferenca rajonale e organizuar nga KiE. Në muajin korrik përfaqësues të Autoritetit morën pjesë në konferencën organizuar nga Bashkimi Evropian dhe implementuar nga Këshilli i Evropës për sa i përket eksperiencës rajonale në problematika audiovizive si gjuha e urrëjtjes dhe mbrojtja e minorenëve sipas standardeve evropiane. Në konferencë u referuan praktikat më të mira dhe u propozuan zgjidhje në lidhje me temën kryesore të konferencës. Ekspertë nga Kroacia, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova theksuan qartë rolin

dhe deri në çfarë pike mund të shkojnë autoritetet rregullatorë lidhur me luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe mbrojtjen e minorenëve

8. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL

8.1 Programi i transparencës

Në kuadër të programit të transparencës, Autoriteti i Mediave Audiovizive angazhohet të përditësojë herë pas here informacionin publik në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit. Faqja zyrtare web e AMA-s, www.ama.gov.al, është burim informacioni për shumë media, ekspertë, gazetarë, ndërkombëtarë etj. dhe mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik, duke vënë në dispozicion shumë informacione pa kërkesë, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesa individuale për informacion.

Gjatë vitit raportues, faqja web e AMA-s është riorganizuar duke qenë më e pasur me informacion, dhe më interaktive me palët e interesuara. Një nga risitë e faqes së re të rikrijuar me qëllimin për të qenë më proaktiv, janë formularët e ankesave për çdo fushë veprimi të Autoritetit ku më poshtë janë formularët e ankesave:

- Formular ankese për “shkeljen e kodit të transmetimit”
- Formulatat ankese mbi “licencën apo autorizimin”
- Formular ankese për “drejtorinë e mbikëqyrjes”
- Formular ankese për “masat e tarifave vjetore të miratuara nga AMA
- Formular ankese për “të drejtën e informimit”
- Formular ankese për “caktimet frekuencave”

Në përmbushje të programit të transparencës, në faqen zyrtare të AMA-s, www.ama.gov.al në rubrikën përkatëse të transparencës gjendet informacioni i përditësuar mbi buxhetin vjetor, mbi realizimet për të ardhurat dhe shpenzimet si dhe Informacionin lidhur me procedurat për prokurimet publike të ndjekura nga AMA

Gjithashtu në faqen zyrtare web të AMA-s janë të publikuara të gjitha informacionet në lidhje me strukturën organizative të AMA-s, të dhënat mbi arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë si dhe struktura e pagave për të gjithë nëpunësit e tjerë.

Për vitin raportues pranë AMA-s kanë ardhur rreth 140 (njëqind e dyzetë) kërkesa, të cilat gjendet të pasqyruara edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të autoritetit, www.ama.gov.al nën Rubrikën Veprimtari/Transparenca, ku janë përfshirë edhe kërkesat për kryerjen e shërbimeve nga ana autoriteti.

Ky program transparence është në përputhje të plotë me ligjin mbi të drejtën e informimit, dhe rrit dukshëm imazhin institucional duke përmirësuar qeverisjen e Autoritetit.

Ndaj vendimeve të AMA-s të vitit 2016, është ushtruar e drejta e ankimit gjyqësor, prej subjekteve që pretendojnë se u janë cenuar të drejtat, për 18 vendime. Krahas vendimeve të ankimuara për herë të parë gjatë periudhës raportuese, veprimtaria e AMA-s në raport me proceset gjyqësore, ka vijuar edhe kundrejt çështjeve, të cilat janë duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, AMA si subjekt i së drejtës ka investuar gjykatën në cilësinë e palës paditëse, për 9 çështje.

AMA aktualisht, është e përfshirë në një numër procesesh gjyqësore, nga të cilat 5 çështje janë në proces gjykimi në gjykatat e shkallës së parë civile dhe administrative, 66 janë në proces gjykimi në gjykatat e apelit civile dhe administrative dhe 29 janë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Lartë. Shumica e proceseve gjyqësore janë të mbartura prej viteve të kaluara.

8.2 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore

Gjatë vitit raportues në funksion të objektit të punës për organizimin dhe zbatimin e detyrave që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore sipas legjislacionit në fuqi, AMA ka pasur në fokus të veprimtarisë së tij ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike të burimeve njerëzore, rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit, si dhe respektimin e normave të etikës.

Menaxhimi i burimeve njerëzore përbën elementin kyç në krijimin e një administrate civile profesionale, efektive dhe të përgjegjshme, ndaj AMA ka synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standardet dhe praktikatat me të mira evropiane në fushën e medias.

Administrata ka organizuar dhe drejtuar punën për zbatimin me përpikëri të legjislacionit të shërbimit civil, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, efikasitet në veprim, zhvillimit të karrierës brenda shërbimit civil, si dhe përmirësimit të sistemit të trajnimit të nëpunësve.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë në përmbushje të detyrave funksionale dhe në bashkëpunim me njësitë e tjera organizative të Autoritetit, ka hartuar në fillim të vitit raportues kalendarin e trajnimeve sipas nevojave të parashikuara për trajnim për çdo nëpunës. Trajnimet, pjesë e këtij kalendari përfshijnë: trajnim të detyrueshëm, trajnim sipas nevojave dhe trajnime të tjera/pjesëmarrjeje. Menaxhimi i procesit të trajnimeve është realizuar duke përcaktuar saktë nevojat për trajnim të stafit në përputhje me problematikat e evidentuara gjatë punës së përditshme.

Në zbatim të politikës dhe strategjisë të ndjekur nga Autoriteti për forcimin e kapaciteteve administrative ekzistuese, alternuar me një proces efikas ligjor rekrutimi, për të finalizuar me sukses hapin e madh të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike, procesi i trajnimit gjatë vitit raportues i ka dhënë mundësi të gjithë punonjësve ekzistues për të rishikuar aftësitë e tyre dhe për të punuar më me efektivitet.

Trajnimet janë realizuar në disa mënyra duke filluar nga ato të drejtpërdrejta brenda institucionit, vendit të punës, trajnimet pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), deri të shkëmbimi i eksperiencave me organizmat ndërkombëtar.

Gjithsej, gjatë vitit 2016 janë trajnuar 15 nëpunës, pranë ASPA-s. Llojet e trajnimeve që këta nëpunës kanë ndjekur pranë ASPA-s kanë qënë:

✓ **Trajnimi i thelluar (gjithsej 11 nëpunës)**

Ky lloj trajnimi i përket njohurive që nëpunësi duhet të përvetësojë në mënyrë të detyruar gjatë periudhës së provës lidhur me:

- Prezantimin me administratën publike
- Aftësitë menaxhuese
- Etikën dhe konfliktin e interesave
- Hartimin e shkresave zyrtare
- Kushtetutën dhe hierarkinë e akteve administrative
- Organizimin dhe funksionimin e Administratës Publike
- Procedurat administrative
- Integrimin Evropian
- Ligjin për shërbimi civil

✓ **Trajnimi sipas nevojave (gjithsej 4 nëpunës)**

Rastet kur janë evidentuar nevoja për përshtatje profesionale me vendin e punës.

- Përdorimi i sistemit qendror të të dhënave shtetërore,(HRMIS) lidhur me menaxhimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të personelit 2 nëpunës pranë ASPA-s.
- Hartimi i kutikulës për burimet njerëzore.
- Menaxhimi i performancës së stafit si dhe politika e saj.
- Menaxhimi i sistemit të planifikimit të integruar.

Gjithashtu janë trajnuar sipas nevojave, pranë Institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me TAIEX, Instrumenti i Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian, me temë: “Media dhe Përputhshmëria me Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave”.

Pjesëmarrësit u trajnuan mbi çështje me interes për mediat si

- Korniza ligjore për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me gazetarinë në Shqipëri dhe në BE;
- Rëndësia e Kodit të Etikës në media, integriteti profesional dhe gazetaria investigative;
- Përparësitë dhe sfidat për ruajtjen e balancës mes gazetarisë së mirë dhe privatësisë së individit në komunitet;

- Balancimi i të drejtës për privatësi dhe shkatërrimit të informacionit me interes publik;
- Respektimi i të dhënave personale dhe të privatësisë në epokën digjitale;
- Përdorimi i kamerave të fshehta për qëllime të gazetarisë investigative;
- Trajtimi i rasteve konkrete të shkeljes së privatësisë, e në veçanti, mbrojtja e të dhënave personale e të miturve etj.

Një mënyrë tjetër efikase trajnimi, ka qënë materializuar në trajnimin me temë “Rritja e imazhit institucional nëpërmjet mënyrave eficiente të komunikimit” me pjesëmarrjen e 37 nëpunësve të saj, ku stafi është trajnuar mbi Kodin e Etikës në Televizion, etikën e komunikimit dhe marrëdhëniet e AMA-s dhe transparenca në media.

Gjithashtu, Sektori i Burimeve Njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë së punës, dhe rritjes së nivelit të performancës të nëpunësve ka implementuar procesin e njohjes së manualeve respektive lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore, performancës dhe politikave të saj, si dhe orientimin e punonjësve të rinj.

8.3 Infrastruktura e Informacionit dhe njohurive

Në kuadër të rritjes së efektivitetit në punë, AMA gjatë vitit 2016 ka ndryshuar pajisjet elektronike dhe njëkohësisht shtuar pajisje të reja në institucion si më poshtë:

- Zëvendësuar rreth 80% e pajisjeve kompjuterike të punonjësve të AMA-s për arsye se kompjuterët ishin tejet të amortizuar dhe ishin bërë pengesë për vijueshmërinë me efektivitet të punës.
- Prokuruar server qendror si domosdoshmëri, në mënyrë që të rritet kontrolli, siguria dhe efica e punonjësve si dhe prokuruar UPS qendror në mënyrë që të mos ndërpritej puna dhe njëkohësisht të mos dëmtohen pajisjet kompjuterike të institucionit, në rast të mungesës së energjisë elektrike
- Prokuruar sistemi informatik (program kompjuterik) për digjitalizimin dhe automatizimin e të gjitha të dhënave të subjekteve audio/audiovizive që licencohen apo autorizohen nga AMA, duke bërë të mundur rritjen e efica në punë si dhe rritjen profesionale të stafit të institucionit.

AMA ka përmirësuar rrjetin elektrik duke bërë të mundur që pajisjet kompjuterike të jenë në një rrjet të pavarur nga pjesa tjetër e rrjetit elektrik, duke rritur sigurinë e mbarëvajtjes në punë ka siguruar dy linja interneti të pavarura për komunikimin e brendshëm të punonjësve, duke siguruar vijimësinë e punës në raste defektesh. Gjithashtu është krijuar Domain-i i institucionit të AMA-s për të rritur sigurinë dhe cilësinë e të dhënave të komunikimit të punonjësve.

Në kuadër të rregullimit të proceseve të administrimit, ruajtjes, funksionimit, përpunimit dhe menaxhimit të të dhënave të informacionit në AMA, janë hartuar rregulloret dhe procedurat për zbatim nga punonjësit e AMA-s, të cilat janë në fazën e miratimit si me poshte vijon:

Nr.	Procedura	Objekti
1	Procedura e ndryshimeve në pajisjen fundore.	Qëllimi i kësaj procedure është përcaktimi i hapave të nevojshëm që do të merren në rast se kërkohen ndryshime për pajisjet teknike fundore ne AMA.
2	Procedura e menaxhimit të incidentit të pajisjeve fundore.	Objekt i kësaj procedure është përcaktimi i hapave të nevojshëm që do të merren për menaxhimin e incidentit të pajisjeve fundore.
3	Procedura e monitorimit dhe mirëmbajtjes.	Në këtë procedurë përfshihen veprimtaria ditore, kontrollet periodike, dhe radha e veprimeve ne rast mirëmbajtje apo zëvendësimi të pajisjeve.
4	Procedura e ndryshimeve në dhomën teknike (dhoma e serverëve)	Qëllimi i kësaj procedure është përcaktimi i hapave të nevojshëm që do të merren në rast se kërkohen ndryshime në infrastrukturën e rrjetit IT në ambientin teknik (dhoma e serverëve).

9. TREGUESIT FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

9.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Autoriteti i Mediave Audiovizive si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Në këtë prizëm përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit si dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të këtyre burimeve ka qenë një ndër objektivat kryesore të realizuara gjatë vitit 2016.

Realizueshmëria e këtyre objektivave vjetore është përqendruar në:

- Rritjen e arkëtueshmërisë së të ardhurave, si lidhur me detyrimet financiare të viteve të mëparshme ashtu edhe me pagesat për vitin 2016;

- Ndjekja sipas dispozitave ligjore të subjekteve debitor ndaj AMA-s, për pagesën vjetore për mbi një vit;
- Kanalizimi i burimeve financiare në përmbushje të funksioneve të AMA-s;

Viti 2016, krahasuar me vitet e kaluara, ka shënuar rritje të ndjeshme të të ardhurave të Autoritetit, si rrjedhojë e masave të marra për sigurimin e zbatueshmërisë së ligjit.

Realizimi i zërit “Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë” për vitet 2012 - 2016, paraqitet si vijon:

Arkëtimi i realizuar sipas viteve i të ardhurave vjetore	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Shuma e të ardhurave vjetore	131,455,318	118,061,085	116,958,810	102,413,197	140,277,514	160,610,044
Arkëtimi i realizuar i të ardhurave	60,363,439	43,291,430	42,899,741	61,525,629	111,769,232	140,241,752
Realizimi në %	46%	37%	37%	60%	80%	87%

Si pasojë e detyrimeve të mbartura ndër vite, për pagesat për licencë/autorizim dhe tarifat për shërbimet radiotelevizive, AMA gjatë vitit 2016, për 32 subjekte ka marrë vendimi për heqjen e licencës/autorizimit, nga këta subjekte, 2 shlyen tërësisht detyrimin ndaj AMA-s, ndërkohë 30 subjekte mbeten ende debitor.

Detyrimi në total i këtyre debitorëve ndaj AMA-s është në masën prej **93,722,615** Lekë. Aktualisht janë ngritur 8 akt – padi nga AMA për vjeljen e këtyre detyrimeve. Lista e subjekteve që i është hequr licenca/autorizimi është si më poshtë:

NR.	LLOJI SUBJEKTIT	EMËRTIMI	PAGESA PER LICENCË	KV(TV ME KABËLL)/TARIFA PËR SHËRBIME RTV (FM DHE TV)	DETYRIMI TOTAL
1	TV ME KABËLL	Bajrami Net	2,410,000	231,000	2,641,000
2	TV ME KABËLL	Apollnet	3,130,000	399,000	3,529,000
3	TV ME KABËLL	Tv kabllor Dushk	362,500	23,625	386,125
4	TV ME KABËLL	Albania Shkodër	3,050,000		3,050,000
5	TV ME KABËLL	Albania Kombi	2,150,000		2,150,000
6	TV ME KABËLL	Kombi	3,554,170		3,554,170
7	TV ME KABËLL	Sky digital	20,511,500	2,244,000	22,755,500

8	TV ME KABËLL	CA Përmeti	600,000	48,000	648,000
9	TV ME KABËLL	Dire	480,000	65,280	545,280
10	TV ME KABËLL	Mirdita	733,630		733,630
11	TV ME KABËLL	Lissus	352,000	40,200	392,200
12	TV ME KABËLL	Alb Pajovë	868,670	93,840	962,510
13	TV ME KABËLL	Hudenisht	149,910		149,910
14	TV ME KABËLL	Lushnjë	749,800		749,800
15	IPTV	Tring IPTV	18,520,000		18,520,000
16	OSHMA	Stream online	430,000	54,000	484,000
17	RADIO	Boom-Boom	106,900	60,000	166,900
18	RADIO	Univers	635,100	374,400	1,009,500
19	RADIO	Clazz	497,500	249,600	747,100
20	RADIO	Capital	218,870	144,000	362,870
21	RADIO	Glob	29,020	20,800	49,820
22	RADIO	Hit	69,100	23,200	92,300
23	TV SATELITOR	Al-Sat	24,557,700		24,557,700
24	TV VENDOR	Përmeti	143,000	451,500	594,500
25	TV VENDOR	Riviera 11	170,400	240,000	410,400
26	TV VENDOR	2A	51,400		51,400
27	TV VENDOR	Era	34,300	120,000	154,300
28	TV VENDOR	7	45,800		45,800
29	TV VENDOR	Veleçik	321,400	192,000	513,400
30	TV VENDOR	Koha	2,035,500	1,680,000	3,715,500
DETYRIMI TOTAL					93,722,615

Autoriteti gjatë 2016, ka bërë manaxhimin e burimeve financiare nëpërmjet parashikimeve të buxhetuara në fillim të vitit në buxhetin vjetor të miratuar me vendimin e AMA-s nr. 101, datë 09.12.2015. Viti 2016 ka shënuar sërish një vit të rëndësishëm në rolin mbështetës dhe nxitës të AMA-s, lidhur me zhvillimin e studimeve të tregut audiovizual, si dhe sfidat dhe problemet që procesi i afërm i digjitalizimit sjell për Shqipërinë. Me fokus procesin e digjitalizimit janë mbajtur gjatë këtij viti studime dhe kërkime që do të ndihmojnë aktorët e përfshirë në këtë proces për sfidat dhe të panjohurat që do hasen gjatë rrugës.

Gjithashtu, janë mbështetur financiarisht nga AMA projekte lidhur me trajnime të gazetarëve dhe aktorëve të medias audiovizive, gjithashtu janë ndjekur angazhimet me palët homologe si dhe janë mbajtur trajnime të stafit për rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore.

Gjithashtu në mbështetje të Strategjisë për kalimet nga transmetimet analoge në transmetimet digjitale, gjatë vitit 2016, është siguruar financim nga Buxheti i Shtetit në masën **105,000,000 lekë**

për realizimin e fushatës për informimin e publikut sipas aktiviteteve të përcaktuara në këtë Strategji, të cilat ishin:

- Transmetimi i spoteve sensibilizuese publicitare;
- Transmetimi i emisioneve special;
- Transmetimi i njoftimeve;

Në bazë të aktiviteteve të mësipërme AMA gjate vitit 2016, ka prokuruar fondin prej 102.350.000 lekë përkatësisht sipas këtyre zërave në peshë specifike me numërin e transmetimeve të përcaktuara sipas Strategjisë. Ndarjen e fondit sipas zërave të përcaktuar më lartë dhe realizimin e tyre gjatë vitit 2016, gjendet në tabelën e mëposhtme:

Zeri i shpenzimeve	Ndarja fondit të akorduar nga MF (në lekë)		Realizimi në vlerë	Realizimi në %
	60.000.000	45.000.000		
Shpenzimet për transmetimin spoteve	42,195,557	44,350,000	49,291,557	57
Shpenzimet për emisione speciale	11,728,523		11,728,523	100
Njoftimet për 1 allotment	4,075,920		4,075,920	100
Totali Lekë me TVSH	58,000,000	44,350,000	65,096,000	

9.2 Pasqyrat financiare

Pasqyra e aktivitetit dhe pasivit për vitet 2015 - 2016		
	31.12.2016	31.12.2015
Aktivet		
Gjendje Inventari	3,039,950	2,582,335
Kërkesa për arkëtim ndaj të tretëve	313,109,857	302,138,821
-Klientë për licence	70,699,449	72,043,762
(Klientë të arkëtueshëm)	18,298,879	72,043,762
(Klientë hequr licenca)	90,167,115	
(Kliente hequr licenca të zhvlerësuar)	-37,766,545	
-Klientë për tarifën shërbime RTV	10,307,801	12,436,424
(Klientë të arkëtueshëm)	6,752,301	
(Klientë hequr licenca)	3,555,500	
-Klientë për gjoba	231,625,817	216,650,608
-Klientë për kamatë vonesa	476,790	1,008,027

Të tjera kërkesa ndaj të tretëve	68,907	191,782
-Paradhënie	64,166	139,758
-Diferenca nga shteti per tatime dhe taksa	4,741	52,024
Arka dhe Banka	100,617,029	80,913,101
Totali i aktiveve Afatshkurtra	416,835,743	385,826,039
Aktivet Afatgjata		
Studime dhe kerkime	6,308,708	3,798,277
Aktive të qëndrueshme neto	51,078,663	16,099,287
- Inventar ekonomik	264,270	
- Instalime teknike, pajisje, vegla pune	11,367,490	
- Mjete transporti	4,547,661	
- Shpenzime per ndertesa administrative	34,899,242	
Totali i Aktiveve Afatgjata	57,387,371	19,897,564
Totali i Aktiveve	474,223,114	405,723,603
Fondet e veta	74,459,019	197,709,647
Transferta nga MF per Fushaten e Informimit te Publikut per Digjitalizimin	105,000,000	
Rezultati ushtrimor i vitit	-39,205,869	-123,250,627
Detyrimet afatshkurtra ndaj të tretëve		
-Detyrime mbi klientë	230,064,562	218,937,286
-Detyrime ndaj Furnitorëve	11,234,158	67,590
-Detyrime ndaj shtetit për tatime dhe Kontribute	1,586,605	911,137
-Kreditorë të viteve të mëparshme	89,494,892	111,348,570
-Kreditore për mjete në ruajtje	1,589,747	
Totali i Detyrimeve	333,969,964	331,264,583
Totali i Pasivit	474,223,114	405,723,603

Pasqyra të ardhura dhe shpenzime në datë 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2016			
Nr.	Emërtimi	Viti 2016	Viti 2015
A	Të Ardhurat korente të periudhës	196,156,075	151,734,678
1	Të Ardhura nga Licenca/autorizim	178,623,198	132,362,046
2	Të ardhura si agjent tatimor	992,725	865,594
4	Të ardhura nga përpunimi administrative	5,440,000	3,720,000

5	Të ardhura nga interesat bankare	120,838	185,796
6	Të ardhura të tjera nga gjobat, kamatvonesa,	10,979,314	14,601,242
B	Shpenzimet Operative	89,316,932	192,196,676
1	Materiale zyre kancelari	1,584,513	2,283,925
2	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	73,068,973	59,705,639
3	Shpenzime mirëmbajtje të godinës	879,500	288,100
4	Shërbime mirëmbajtje paisje elektronike	378,970	1,286,520
5	Shpenzime për shërbime furnizuese	5,607,447	3,378,438
6	Shpenzime transporti dhe mirëmbajtje të makinave	2,640,621	3,213,688
7	Taksa Vendore	15,000	11,770
8	Shpenzime gjyqë, legale	5,141,908	122,028,596
C	Shpenzime të Veprimtarisë funksionale të AMA-s	22,358,406	14,540,828
1	Konsulenca, trajnime, studime tregu	4,668,837	2,622,134
2	Shpenzime përfaqësimi	4,770,021	5,981,894
3	Shpenzime për digjitalizimin	12,919,548	5,936,800
D	Fond i Vecante nga MF për Fushatën e Informimit të Publikut	67,095,980	
E	Humbje të vitit	8,621,100	50,600,500
	Shfuqizim gjobash	3,840,000	40,120,000
	Heqje licence/autorizimi, sistemime	4,781,100	10,480,500
F	Amortizime dhe zhvlerësime të aktiveve të trupëzuara	10,202,981	16,528,633
G	Transferta për organizatat e huaja	0	1,118,667
H	Shuma të parashikuara për rreziqe	37,766,545	
	TOTAL	-39,205,869	-123,250,627

Shënimet e pasqyrave Financiare:

1. Në zërin "Shpenzime të jashtëzakonshme: janë përfshirë humbjet nga shfuqizimi i gjobave të viteve të kaluara, me vendim të AMA-s dhe humbjet nga debitorët e viteve të kaluara, të cilët kanë pësuar sistemim të detyrimit ndaj AMA-s, për arsye të ndryshme si zvogëlim të zonës të ofrimit të shërbimit.
2. Zëri i "Shpenzimeve gjyqësore legale", janë përfshirë proceset gjyqësore të viteve të mëparshme, të kthyer në tituj ekzekutiv gjatë vitit 2017.